



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 429 Akti

Nr. 548 Vendimi
Tiranë, më 6.7.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Brunilda Bektoshi	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 4.7.2022, në orën 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Leonard Filopati**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bektoshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Leonard Filopati, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Leonard Filopati do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.
4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 20.12.2019, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Leonard Filopati, si dhe caktoi kryesuese të trupit gjykues komisioneren Firdes Shuli. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
5. Në datën 9.1.2020, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
6. Në datën 13.6.2022, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Leonard Filopati, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e tij brenda 13 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Në datën 13.6.2022, subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 13 ditëve. Në datën 27.7.2022, subjekti dërgoi në mënyrë elektronike shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ, duke parashtruar se kërkonte në mirëkuptim që çdo kërkesë e Komisionit të planifikohej pas datës 2.7.2022, pasi ndodhej jashtë shtetit, kërkesë e cila u mbajt në konsideratë nga trupi gjykues.
8. Trupi gjykues, në datën 28.6.2022, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Leonard Filopati, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke njoftuar në të njëjtën datë subjektin se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 4.7.2022, në orën 13:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Leonard Filopati u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Pas seancës subjekti depozitoi sërish provat dhe shpjegimet e tij pranë sekretarisë gjyqësore përfshirë edhe ato të munguara, sipas njoftimit¹ të Komisionit, po në datë 4.7.2022, ora 11:17, të cilat u administruan.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Leonard Filopati. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 4.7.2022, për të rifilluar në datën 6.7.2022, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Z. Leonard Filopati ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLP-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese² dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

¹Disa akte të lidhura me procedimin penal ndaj shtetasit I.D., të cilat nga verifikimi i Komisionit nuk ishin depozituar.

²Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

13. ILDKPKI-ja, me raportin nr. *** prot., datë 7.6.2019, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Leonard Filopati, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; (ii) ka mospërputhje të vlerave të pasurive dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) argumentimet e provat e depozituara në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2) të datës 26.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi, si vijon:

1. Pasuria apartament me sip. 84 m², ndodhur në rrugën “***”, pallati “***”, kati ***, Tiranë, me kredi në “Tirana Bank”. Vlera e apartamentit 70.000 euro. Shoqëruar me kontratat përkatëse. Vlera: 70.000, euro nga të cilat 20.000 euro të kursyera ndër vite dhe 50.000 euro marrë kredi për të cilat subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³.

1.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar: (i) mospërputhje të çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 84.13 m², në Selitë, deklaruar nga subjekti në vlerën 70.000 euro referuar kontratës së sipërmarrjes dhe çmimit prej 33.780 euro, të përcaktuar në kontratën e shitjes, me të cilën është bërë regjistrimi i apartamentit në hipotekë; (ii) diferencë të krijuar në buxhetin e shtetit sa i përket derdhjes së detyrimeve tatimore, si rezultat i diferencës së çmimit të deklaruar të paguar për blerjen e apartamentit dhe çmimit të regjistruar sipas kontratës së shitjes; (iii) mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me pagesat e kryera për likuidimin e apartamentit në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., për blerjen e apartamentit në shumën 70.000

³(i) Kontratë sipërmarrje nr. *** kol., datë 10.8.2007, nënshkruar ndërmjet palës sipërmarrëse e investitore shoqëria “***” sh.p.k. dhe palës porositore Leonard Filopati, të një apartamenti të ndodhur në Selitë, Tiranë, me sip. 96.52 m² (bashkë me sipërfaqen e përbashkët), me vlerë 70.000 euro; (ii) kontratë kredie bankare, datë 6.11.2006, me palë kredidhënëse “Raiffeisen Bank” dhe palë kredimarrëse Leonard Filopati, të shumës 1.000.000 lekë, me qëllim “për përdorim personal”, me afat shlyerje të kredisë 60 muaj; (iii) kontratë kredi bankare për shtëpi nr. ***, datë 21.4.2008, nënshkruar ndërmjet “Tirana Bank” dhe kredimarrësve Leonard Filopati e B.H, në shumën 51.000 euro (50.000 euro me qëllim blerje apartamenti dhe 1.000 euro si garanci, për lëshimin e një karte krediti në emër të kartëmbajtësit Leonard Filopati). Kohëzgjatja e kredisë për 25 vjet. Pagesa e kredisë do të sigurohet me hipotekën mbi pasurinë e paluajtshme “apartament” me sip. 84.13 m², me adresë në ***, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Karabinasë nr. ***, datë 7.8.2007, në pronësi të shoqërisë “***” sh.p.k. (Aneks nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së).

euro, pasi fondet e përfituara me kredi dhe të deklaruar si burim për likuidimin e apartamentit janë tërhequr *cash* dhe pa provuar destinacionin e përdorimit të tyre.

1.2 Nga hetimi administrativ për këtë pasuri, Komisionit i kanë rezultuar faktet si vijon: Subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri, në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në vitin 2012, me përshkrimin “apartament banimi me sip. 84 m² (neto), 96.52 m² (bruto), me adresë: ***, ***, Tiranë, sipas kontratës së shitblerjes së vitit 2008, me vlerë totale 70.000 euro. Burim krijimi: (a) vlera 20.000 euro kursime familjare ndër vite; (b) vlera 50.000 euro kredi në “Tirana Bank”. Pjesa takuese: 100%. Po në këtë deklaratë, në rubrikën e “detyrimeve financiare”, subjekti ka deklaruar kredi për apartament banimi në “Tirana Bank”, marrë në vitin 2008, në shumën 50.000 euro, me këst 270 euro/muaj.

1.3 Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në, kjo e fundit nëpërmjet Drejtorisë Vendore Tirana Rurale¹⁴ konfirmon ekzistencën e pasurisë apartament, me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe 84.13 m², në emër të subjektit të rivlerësimit. Kjo drejtori ka bashkëlidhur kontratën e shitjes nr. ***, datë 11.6.2008, me palë shitëse shtetasin TH.A, ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “****” sh.p.k. (NIPT ***) dhe palë blerëse Leonard Filopati, për apartamentin me sip. 84.13 m². Çmimi i shitjes së apartamentit është në vlerën 33.780 euro, vlerë e cila është likuiduar nga pala blerëse, jashtë zyrës noteriale. Edhe në kartelën e pasurisë së paluajtshme, në emër të subjektit të rivlerësimit Leonard Filopati, rezulton se vlera e pasurisë apartament është 33.780 euro.

1.4 Subjekti rivlerësimit, si gjatë hetimit, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, ka depozituar për këtë pasuri kontratën e sipërmarrjes⁵ nr. ***, datë 10.8.2007. Në këtë kontratë vlera totale dhe mënyra e likuidimit të kësaj pasurie ka qenë e parashikuar si vijon: *“Vlera e apartamentit është 70.000 euro, nga e cila vlera prej 28.000 euro është likuiduar menjëherë me nënshkrimin e kontratës (vlera 20.000 euro është likuiduar nga porositësi në dorë ndërsa vlera 8.000 euro është arkëtuar nëpërmjet kredisë së marrë nga porositësi në ‘Raiffeisen Bank’). Diferenca e mbetur prej 42.000 euro do të likuidohet nga porositësi nëpërmjet një kredie bankare. Pala sipërmarrëse merr përsipër t’i dorëzojë porositësit apartamentin në datën 28.10.2007”*.

1.5 Komisioni i ka kërkuar subjektit⁶ të shpjegojë dhe të depozitojë dokumentacionin provues, lidhur me konstatimin e dy vlerave të ndryshme për çmimin e blerjes së kësaj pasurie, pra, 70.000 euro në kontratën e sipërmarrjes dhe 33.780 euro në kontratën e shitjes. Subjekti, në përgjigjen e tij, ka sqaruar se: *“Referuar kontratës së shitjes nr. ***, datë 11.6.2008, e deklaruar nga shtetasi TH.A, ku ka përcaktuar vlerën 33.780 euro, nuk i mban mend detajet dhe nuk i kujtohet të jetë bërë prej tij, por mund të jetë kontratë që sipërmarrësi e ka përpiluar vetë dhe depozituar nga vetë ai”*. Sipas subjektit në kushtet, kur në kontratën e datës 21.4.2008 është pasqyruar një vlerë më e madhe dhe, më pas, për të njëjtin apartament është lidhur një kontratë me vlerë më të vogël, i penalizuar në këtë transaksion është ai në cilësinë e blerësit, pasi nëse në një moment të caktuar do të bëhej rivlerësimi i apartamentit nga institucionet shtetërore, mbi vlerën e çmimit të shitjes si në rastin konkret, nëse e rishet apartamentin, me humbje financiare do të rezultonte ai, për më tepër që për këtë fakt është vënë në dijeni vite më vonë. Subjekti ka shpjeguar se në këtë periudhë nuk ka pasur detyrimin për të deklaruar pasurinë dhe vëmendja e tij nuk ka qenë kaq e madhe mbi detajet dhe të dhënat e dokumenteve, sa sikurse mund të jetë pas vitit 2012, kur ka filluar të deklarojë rregullisht, të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e krijuara“.

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 2.6.2020.

⁵Aneks nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së dhe në shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2020, nga ILDKPKI-ja, në dosjen e Komisionit.

⁶Pyetësor nr. 2, datë 28.2.2022.

1.5.1 Ka rezultuar se subjekti, po për këtë mospërputhje, pranë ILDKPKI-së, ka deklaruar se⁷: “...ky apartament është blerë nga ana ime në vitin 2008 në vlerën 70.000 euro. Shuma e paguar nga ana ime është ajo e deklaruar kurse në kontratë është shënuar 33.780 euro nga firma ndërtuese në momentin e regjistrimit në hipotekë”.

1.5.2 Komisioni, për një hetim shterues, kërkoi⁸ informacion edhe nga shoqëria ndërtuese “***” sh.p.k., e cila në përgjigjen e saj informoi se nuk dispononte dokumentacion për shkak të kohës së largët (më shumë se 14 vite), ndryshimit të ambienteve të zyrës dhe stafit.

1.6 Për këtë pasuri, UKT-ja⁹ nuk ka konfirmuar kontratë për furnizimin me ujë, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, ndërsa subjektit i është kërkuar¹⁰ të depozitojë kontratën për shërbime me UKT-në, për këtë pasuri dhe ka depozituar librezën përkatëse që konfirmon pagesat me këtë operator.

1.7 FSHU-ja¹¹ ka konfirmuar kontratë për furnizim me energji elektrike në emër të subjektit, nr. ***, në adresën ***, ***, ***, në instancën Tiranë, me të dhëna kabina Private ***. Gjithashtu, subjektit i është kërkuar¹² të depozitojë librezën që i përket furnizimit me energji elektrike dhe në përgjigje ka depozituar dy libreza të furnizimit me energji elektrike, ku rezulton se shtetasi Leonard Filopati ka kontratën me nr. ***, qendra ***.

1.7.1 Komisioni, nisur nga deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting*, në ILDKPKI, si dhe gjatë hetimit, sa i takon vlerës së paguar për këtë pasuri, në analizën financiare të kryer për pasuritë e subjektit të rivlerësimit, ka marrë në konsideratë vlerën 70.000 euro, si çmim blerje, duke verifikuar, më tej, burimet e krijimit të saj, për të cilat ka konstatuar faktet si vijon:

1.8 Subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën *Vetting* se burim krijimi për këtë pasuri¹³ janë: 20.000 euro të kursyera ndër vite dhe 50.000 euro marrë kredi në “Tirana Bank”.

1.8.1 Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 20.000 euro të kursyera, ndër vite, ka rezultuar se subjekti, si në deklaratën *Vetting* por edhe në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës 2012, ka deklaruar si burim krijimi, 20.000 euro kursime familjare ndër vite. Gjatë hetimit¹⁴, subjekti ka sqaruar se kjo shumë është përfituar nga shitja e apartamentit me sip. 58.42 m², me adresë ***, Tiranë. Subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në ILDKPKI¹⁵, ku për burimin e shumës 20.000 euro ka deklaruar: “Vlerën prej 20.000 euro kursime, pasi në vitin 2006 kam shitur apartamentin e deklaruar në vitin 2004”.

1.8.2 Komisioni hetoi për vlerën 20.000 euro të krijuar nga kursimet ndër vite dhe shitja e pasurisë apartament, për të cilat, hetimi nxori në pah faktet e mëposhtme:

1.8.3 Sa i takon të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit, ka rezultuar se këtë pasuri subjekti e deklaroi për herë të parë në deklaratën periodike¹⁶ të vitit 2005, me përshkrimin “apartament banimi sip. 60 m², me adresë ‘Komuna e Parisit’, Tiranë”.

⁷Referuar “procesverbalit mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 21.1.2016, të administruar me përgjigjen nr. *** prot., datë 5.10.2020, të ILDKPKI-së, në dosjen e Komisionit.

⁸Me shkresën nr. ***prot., datë 18.3.2022.

⁹Me shkresën nr. K-*** prot, datë 18.5.2020.

¹⁰Me pyetësin nr. 2, datë 28.2.2022.

¹¹Me shkresën nr. ***, datë 15.5.2020, në dosjen e Komisionit.

¹²Pyetësor nr. 2 datë 28.2.2022.

¹³Komisioni mban në vëmendje që kjo pasuri është krijuar në një periudhë përpara se subjekti rivlerësimit të emërohej në detyrë dhe të ishte objekt i ligjit për deklarim, por për faktin se është një pasuri e cila zotërohet në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, është hetuar mbi çdo burim krijimi.

¹⁴Në pyetësin nr. 2, datë 28.2.2022.

¹⁵Referuar “procesverbalit mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 21.1.2016, të administruar me përgjigjen nr. *** prot., datë 5.10.2020, të ILDKPKI-së, në dosjen e Komisionit.

¹⁶Deklarata e dorëzuar nga ILDKPKI-ja mban vitin 2004, por duhet të jetë lapsus i institucionit, pasi subjekti është emëruar si oficer i policisë gjyqësore më 1.8.2005 dhe e ka dorëzuar deklaratën më 12.10.2005.

1.8.4. Nga hetimi ka rezultuar se shitja e kësaj pasurie konfirmohet¹⁷ me kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. *** kol., datë 24.3.2006, me palë shitëse shtetasit Leonard Filopati dhe palë blerëse shtetasit T dhe P.A, në vlerën 1.900.000 lekë.

1.8.5 Komisioni analizoi kontratën e shitjes, e cila për nga forma, por edhe nga pasojat e prodhuara, rezulton komfor legjislacionit civil, pasi ka parashikuar palët kontraktore, objektin, ka përcaktuar vlerën e shitjes së pasurisë, është nënshkruar me vullnetin e lirë të palëve, duke u regjistruar në hipotekë në favor të blerësit dhe, për rrjedhojë, shuma 1.900.000 lekë është e ardhur e ligjshme e përdorur, gjithashtu, si një ndër burimet e krijimit të pasurisë apartament objekt vlerësimi.

1.8.6 Meqenëse kjo shumë është përdorur si burim i kështit 20.000 euro, dhënë nga subjekti me nënshkrimin e kontratës, Komisioni kreu analizën financiare pasqyruar në tabelën nr. 2, për të verifikuar aftësinë paguese edhe për të ardhurat e tjera të krijuara nga subjekti, të cilat janë nevojitur për të plotësuar shumën 20.000 euro, për të cilat nuk konstatoi pamundësi financiare për krijimin e tyre.

1.8.7 Komisioni hetoi, gjithashtu, edhe lidhur me mundësinë për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2004, edhe pse paraprakisht vërejtë se nuk i përket periudhës së rivlerësimit.

1.8.8 Nga hetimi¹⁸, Komisionit i rezultoi se ky apartament ishte blerë nëpërmjet kontratës së shitjes nr. ***, datë 5.2.2004, nga shtetasja A.K (V), në vlerën 1.950.000 lekë. Meqenëse kishte mospërputhje midis vlerës së deklaruar nga ana e subjektit dhe kontratës së shitjes, Komisioni e ka pyetur subjektin, i cili në përgjigje ka sqaruar¹⁹ se *vlera prej 5.000.000 lekësh ka qenë një vlerësim apartamenti sipas logjikës së apartamenteve në Tiranë në zonat e mira të saj, zonë ku futet edhe ***, Tiranë, por kërkesa blerëse është ajo që përcakton çmimin dhe për shkak të nevojës së ngutshme për shitjen e saj, vlera reale e saj është vlera e pasqyruar në kontratë.*

1.8.9 Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të kësaj pasurie, për të cilën, subjekti deklaroi²⁰ se *për sa i kujtohej është blerë me kredi bankare në datën 22.1.2004, në Bankën Tregtare të Greqisë me vlerë kredie 20.000 euro.* Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar²¹: (i) dokumentin për miratimin e kredisë në vlerën 20.000 euro nga Banka Tregtare e Greqisë, datë 22.1.2004, për blerje apartamenti, ku cilësohet së kredia do të disbursohet në përfundim të procedurës ligjore për vendosjen e hipotekës së shkallës së parë mbi pronën që do të blihet; (ii) kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 16.2.2004, mes Bankës Tregtare të Greqisë dhe shtetasit Leonard Filopati, për pronën e cila po blihet.

1.8.10 Nga korrespondenca e Komisionit me “ABI Bank”²² konfirmohet disbursimi i kredisë në shumën 20.000 euro, në datë 24.2.2004 dhe tërheqja, në po këtë datë, në vlerën 19.000 euro nga subjekti.

1.8.11 Komisioni, në tërësi të fakteve të dala nga hetimi, vërejtë se edhe pse kredia ishte disbursuar pas nënshkrimit të kontratës, dokumenti bankar për miratimin e kredisë në vlerën 20.000 euro në favor të subjektit ka vendosur kushtin se kredia do të disbursohet në përfundim të procedurës ligjore për vendosjen e hipotekës së shkallës së parë mbi pronën që do të blihet. Komisioni, në kushtet që kontrata e shitjes ishte nënshkruar më 5.2.2004 me qëllim hipotekimit të pronës dhe, më pas, në datën 16.2.2004 ishte nënshkruar kontrata e hipotekimit mes bankës dhe subjektit, faktor këto që kanë përmbushur pritshmëritë e miratimit të kredisë, konstatoi se provohet burimi i ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie.

¹⁷Akte të depozituara nga ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Jug, shkresë nr. *** prot., datë 27.5.2020.

¹⁸Shkresë nr. *** prot., datë 7.5.2020, nga ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Jug.

¹⁹Pyetësor nr. 2, datë 28.2.2022.

²⁰Pyetësor nr. 2, datë 28.2.2022.

²¹Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

²²Shkresë nr.*** prot., datë 12.5.2020.

1.9 Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 50.000 euro, kredi në “Tirana Bank”, nga hetimi administrativ, Komisionit i rezultoi se kjo kredi është deklaruar në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës e vitit 2012 dhe, në vijim, është deklaruar në deklaratat periodike në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” dhe në deklaratën *Vetting*.

1.9.1 Kredia konfirmohet me kontratën²³ e kredisë nr. ***, datë 21.4.2008. Sipas kontratës, subjekti rivlerësimi dhe bashkëshortja kanë përfituar kredinë në shumën 51.000 euro, e cila do të përdorej për: (a) 50.000 euro për blerje apartamenti; dhe (b) shumën 1.000 për garanci për lëshimin e një karte krediti “Visa Card”.

1.9.2 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar²⁴, rezultoi se kredia është disbursuar në dy këste përkatësisht: në datën 29.4.2008, shuma 41.600 euro dhe në datën 31.07.2008, shuma 8.400 euro.

1.9.3 Komisioni vërejti se në kushtet që kontrata e shitjes për këtë apartament ishte lidhur në datën 11.6.2008, ku cilësohej se vlera është likuiduar jashtë zyrës noteriale, dukej se disbursimi i fundit në shumën prej 8.400 euro, në datë 31.7.2008 nuk mund të kishte shërbyer si burim për blerjen e këtij apartamenti, pasi datonte pas kontratës së shitjes dhe regjistrimit të pasurisë.

1.9.4 Nga ana tjetër, Komisioni duke konstatuar se pas disbursimit të shumës 41.600 euro, vetëm shuma 25.000 euro, rezultonte e tërhequr (*respektivisht: shuma 3.000 euro në datën 8.5.2008; shuma 9.000 euro, në datë 9.5.2008; shuma 8,000 euro, në datën 20.5.2008; si dhe shuma 5.000 euro, në datën 30.5.2008*), i kërkoi shpjegime²⁵ subjektit, i cili deklaroi se: *“Bazuar në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 10.8.2007, ku janë specifikuar mënyra e pagesës shumat e pagesës si edhe detyrimet e ndërtuesit, lidhur me punimet që ai do të kryente etj. Megjithëse ka kaluar një kohë shumë e gjatë, por kujtoj se me ndërtuesin kisha rënë dakord edhe verbalisht që përveç specifikimeve në kontratën e mësipërme, do të kryente punime me cilësore se hyrjet standarde, ku unë mund të zgjidhja pllakat, dyert, dhe konvertimin e pllakave me parket laminat nëse dëshiroja, në tre opsionet që ai do të ofronte brenda çmimi të apartamentit, si edhe pagesa e fundit e këstit të fundit të këtij apartamenti do të bëhej pas kryerjes së këtyre punimeve, si garanci lidhur me punimet e kryera prej tij. Me sa kujtoj në qershor të 2008 ndërtuesi nuk kishte bërë këto punime siç edhe kishte premtuar dhe se këto punime janë bërë rreth muajt korrik të vitit 2008, prandaj edhe tërheqja e kësaj shume në bankë është bërë në datën 31.7.2008, pra, pasi ai ka kryer punimet e mësipërme, ku edhe është likuiduar totalisht ndërtuesi. Nuk më kujtohet saktë shuma që i është dhënë ndërtuesit pas datës 31.7.2008, por them me siguri se vlera 8.400 euro e konstatuar prej jush ka shërbyer për blerjen këtij apartamenti si këst i fundit pas punimeve të kryera prej tij.*

Shuma e sipërcituar ka qenë gjendje në bankë, por është mbajtur si garant derisa ndërtuesi ka bërë edhe punimet e premtuara dhe, më pas, kjo shumë ka shërbyer si këst i fundit për blerjen e këtij apartamenti. Për të vërtetuar dhëniet e sipërcituar do t'ju vë në dispozicion edhe një deklaratë të vetë ndërtuesit mbi këtë fakt”.

1.9.5 Komisioni vërejti se në deklaratën e depozituar nga subjekti rivlerësimi, administratori dhe ortaku i vetëm i shoqërisë “***” sh.p.k., deklaroi se: *“në qershor të vitit 2008 unë si ndërtues nuk i kisha bërë disa nga këto punime siç edhe i kisha premtuar. Mesa kujtoj këto punime janë bërë rreth muajt korrik të vitit 2008 dhe pasi unë kam kryer këto punime ai më ka likuiduar totalisht. Nuk më kujtohet saktë shuma sa ishte kësti i fundit por mendoj 8.000 ose 10.000 euro apo ndonjë shumë tjetër e përafërt me to, di që pasi unë kreu ato punime që i kisha premtuar ai më ka likuiduar totalisht lidhur me blerjen e këtij apartamenti”.*

²³Aneks nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁴Statement nga “Tirana Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2020.

²⁵Pyetësor nr. 5, datë 31.3.2022.

1.9.6 Përveç deklaratës së administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., të depozituar nga subjekti, Komisioni, lidhur me mënyrën e likuidimit të kësaj pasurie, kërkoi informacion nga shoqëria, e cila në përgjigjen e saj nuk dha detaje për likuidimin, pasi nuk dispononte dokumentacion.

1.9.7 Komisioni, duke konstatuar se: (i) i vetmi dokumentacion justifikues për pagesat e kryera për këtë pasuri ishte një mandatarkëtim i depozituar²⁶ nga subjekti, i cili provonte se ishte likuiduar shuma 8.000 euro, në datë 15.11.2006 me përshkrimin “likuidim kësti të apartamentit”; (ii) gjendej në kushtet e mungesës së dokumentacionit të plotë për likuidimin e kësaj pasurie; si dhe (iii) për faktin se kredia ishte tërhequr *cash*, deri në fazën e hetimit²⁷, vlerësoi të analizojë likuidimin e kësaj pasurie, sipas parashikimeve kontraktuale.

1.9.8 Në kontratën e sipërmarrjes²⁸ nr. ***, datë 10.8.2007, parashikimi për likuidimin ka qenë se: *vlera 20.000 euro është likuiduar nga porositësi në dorë; ndërsa vlera 8.000 euro është arkëtuar nëpërmjet kredisë së marrë nga porositësi në “Raiffeisen Bank” dhe diferenca e mbetur në vlerën prej 42.000 euro do të likuidohet nga porositësi nëpërmjet një kredie bankare.*

1.9.9 Për shumën 20.000 euro, rrethanat e faktit dhe konstatimet janë përshkruar (në pikën 1.8-1.8.6), ndërsa për vlerën 8.000 euro, e cila është arkëtuar nëpërmjet kredisë, gjatë hetimit²⁹ Komisioni konstatoi se subjekti rivlerësimi ka marrë një kredi në vlerën 1.000.000 lekë, në “Raiffeisen Bank”, të disbursuar në datën 7.11.2006, e cila është tërhequr në dy këste, përkatësisht: në datën 8.11.2006 është tërhequr shuma 500.000 lekë dhe në datën 29.12.2006 është tërhequr shuma 350.000 lekë. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar edhe kontratën e kredisë me “Raiffeisen Bank”, në datën 6.11.2006³⁰.

1.9.10 Lidhur me këtë fakt, subjekti ka deklaruar se: *“Lidhur me konstatimin tuaj se kredia e ‘Raiffeisen Bank’ nuk është cituar në deklaratën Vetting ju sqaroj se nuk ka vend për fshehje apo arsye për mosdeklarim të një kredie bankare, por për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, nuk mund të mbahet mend çdo veprim i kryer. Për më tepër që ka qenë veprim i kryer me bankën dhe që verifikohet në çdo kohë. Në këtë periudhë, unë nuk ka pasur detyrimin për të deklaruar, pasi veprimet kanë ndodhur shumë kohë përpara fillimit të ushtrimit të detyrës dhe ka zgjatuar në një kohë relativisht të shkurtër, pasi është likuiduar nga kredia pasardhëse e marre tek ‘Tirana Bank’, e cila është deklaruar rregullisht”.*

1.9.11 Lidhur me shlyerjen e kësaj kredie, subjekti ka deklaruar se është shlyer nga kredia e marrë në “Tirana Bank”, në shumën 51.000 euro. Më konkretisht, subjekti ka deklaruar³¹: *“Siç kam deklaruar në bankë dhe kjo përputhet edhe me të dhënat e dokumenteve që ka administruar banka për qëllimin e marrjes së kredisë, nga ana ime janë marrë 50.000 euro kredi dhe 1.000 euro ka qenë vlera e kartës së kreditit, e cila nuk është tërhequr asnjëherë dhe është depozituar në bankë në vitin vijues pa u përdorur në asnjë moment. Pra, del e qartë se 42.000 euro do të jepeshin porositësit të apartamentit dhe 8.000 euro do të paguhej ‘Raiffeisen Bank’. Pra, shuma 42.000 euro porositësi +8.000 blerë kredia te ‘Raiffeisen Bank = 50.000 euro”.*

1.9.12 Në lidhje me këto veprime, subjekti ka deklaruar³² se: *“Fakti që është marrë kredi në bankë dhe fakti që është likuiduar kjo kredi nga marrja e një kredie tjetër...është një veprim krejtësisht i ligjshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe plotësisht i verifikueshëm nga çdo i interesuar...”.*

²⁶Pyetësor nr. 2, datë 28.2.2022.

²⁷Mbyllje e rezultateve me vendimin nr. 2, datë 13.6.2022.

²⁸Aneks nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁹Shkresë nr. ***prot., datë 15.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

³⁰Aneks nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së.

³¹Pyetësor nr. 2, datë 28.2.2022.

³²Me pyetësorin nr. 2, datë 22.2.2022.

1.9.13 Komisioni verifikoi lëvizjet e llogarisë së kredisë në “Tirana Bank” dhe rezultoi se nga shuma totale prej 50.000 euro kredi: (i) 6.808,86 euro kanë shërbyer për të shlyer kredinë e marrë në vitin 2006, në “Raiffeisen Bank”; dhe (ii) 41.000 euro janë tërhequr nga subjekti rivlerësimit, gradualisht. Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar të gjitha transaksionet e kryera me kredinë.

Tabela nr. 1

Datë	Debi	Kredi	Përshkrimi
29.4.2008		41,600	Disbursim kredie
2.5.2008	6,808.86		transfer to ALL account
8.5.2008	3,000.00		tërheqje para Leonard Filopati
9.5.2008	9,000.00		tërheqje para Leonard Filopati
20.5.2008	8,000.00		tërheqje para Leonard Filopati
30.5.2008	5,000.00		tërheqje para Leonard Filopati
13.6.2008	4,500.00		tërheqje para Leonard Filopati
25.7.2008	1,500.00		tërheqje para Leonard Filopati
31.7.2008		8,400.00	disbursim kredie
31.7.2008	10,000.00		tërheqje para Leonard Filopati

1.9.14 Nga verifikimi i transaksioneve të kryera me kredinë, Komisioni vërejti se shuma 16.000 euro ishte tërhequr pas datës 11.6.2008, pra, pas nënshkrimit të kontratës së shitjes, si dhe nuk provohej me dokumentacion nëse të gjitha shumat e tërhequra kishin shërbyer për shlyerjen e pasurisë. Po ashtu, vërejti se vetëm shuma 41.000 euro ishte tërhequr³³ dhe dukej se shuma 1.000 euro nuk ishte paguar me burim kredinë e marrë.

1.9.15 Komisioni kreu analizën financiare në dy momente për likuidimin e kësaj pasurie:

1.9.15.i. Së pari, kreu analizën financiare, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar për periudhën nga viti 2006 (kur është shitur pasuria apartament, të ardhurat e së cilës kanë shërbyer si burim) deri në datën 10.8.2007, për shumën 28.000 euro, të paguar deri në këtë datë. Nga përlllogaritjet financiare të kryera³⁴ nga Njësia e Shërbimit Ligjor, Komisioni konstatoi se edhe duke mos marrë në konsideratë ndonjë gjendje *cash*, të mundshme e mbartur para vitit 2006, pasi ishte e pamundur të përcaktohej vlera e saktë, rezultati financiar, pasqyroi faktin se subjekti ka pasur burime të ligjshme për të paguar shumën 28.000 euro.

Tabela nr. 2

Nr.	Përshkrimi	2006 – 10.8.2007
1	TË ARDHURA	3,849,668
	Të ardhura nga paga subjekti	941,627
	Kredi në “Raiffeisen Bank” (2006)	1,000,000
	Të ardhura nga interesat	8,041
	Të ardhura nga shitja e apartamentit me sip.60 m ² (më 24.3.2006)	1,900,000
2	SHPENZIME	433,156
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	194,945
	Shpenzime kredia (“Raiffeisen Bank”) (principal+interes)	203,147
	Shpenzime <i>TIMS</i>	35,064

³³Jo 42.000 aq sa ishte vlera e mbetur për likuidimin e pasurisë.

³⁴Refero tabelën nr. 2.

3	PASURI	2,325,977
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Ap. sip. 84 m ² (kontratë porosie 2007)	3,407,824
	<i>Ndryshim likuiditeti (banka)³⁵</i>	<i>(1,081,847)</i>
	DIFERENCA (1-2-3)	1,090,535

1.9.15.ii Së dyti, lidhur me diferencën prej 42.000 euro, Komisioni kreu analizën financiare nga data 10.8.2007, datë që përkon me likuidimin e shumës 28.000 euro, deri më 11.6.2008, kur është nënshkruar kontrata e shitjes në të cilën cilësohet se vlera është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në këtë drejtim, Komisioni ka përfshirë në analizë tërheqjet e kryera deri në datën e nënshkrimit të kontratës së shitjes, ndërsa lidhur me pretendimin e subjektit, se një pjesë e pagesave janë likuiduar pas datës së kontratës së shitjes, deri në fazën e mbylljes së rezultateve të hetimit, vlerësoi të mos e marrë në konsideratë këtë pretendim.

Tabela nr. 3

Nr.	Përshkrimi	10.8.2007 – 11.6.2008
1	TË ARDHURA	6,757,306
	Të ardhura nga paga subjekti	542,379
	Kredi “Tirana Bank” (2008) në shumën 41.600 euro	5,124,392
	Mbartur nga periudha e kaluar (mundësia për kursim deri më 10.8.2007)	1,090,535
2	SHPENZIME	1,254,352
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	113,850
	Shpenzime kredia (“Raiffeisen Bank”) (principal+interes)	1,029,594
	Shpenzime kredia (“Tirana Bank”) (komisione + sig. prone + sig. jete)	80,956
	Shpenzime kredia (“Tirana Bank”) (principal+interes)	29,953
3	PASURI	6,766,341
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Ap. sip.84 m ² (kontratë shitje 2008)	5,173,665
	Automjet tip “****”, me targa *** (më 4.6.2008)	500,000
	<i>Ndryshim likuiditeti³⁶</i>	<i>1,092,676</i>
	DIFERENCA (1-2-3)	- 1,263,387

1.9.16 Komisioni, nisur nga konstatimet e dala gjatë hetimit, i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, pasi; (i) dukej se subjekti gjendej në pamundësi financiare në vlerën 1.263.387 lekë për të paguar këstet e kësaj pasurie, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare; (ii) nuk provoheshin me dokumentacion justifikues ligjor, pagesat e kryera për likuidimin e apartamentit në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. (*parashikuar në kontratën e sipërmarrjes*), për blerjen e apartamentit në shumën 70.000 euro; (iii) mungonte dokumentacioni justifikues për të provuar destinacionin e kredisë së marrë në “Tirana Bank, në vitin 2008; (iv) dukej se shuma 1.000 euro nuk kishte si burim krijimi kredinë e marrë; (v) dukej se me veprimet kontraktore, ishte favorizuar shoqëria ndërtimore në shlyerjen e detyrimeve tatimore ndaj shtetit, pasi ishte nënshkruar reciprokisht kontrata e sipërmarrjes për këtë pasuri në shumën 70.000 euro, si edhe kontrata e shitjes në shumën 33.780 euro; (vi) dukej se subjekti nuk kishte deklaruar në DPV-në e vitit 2012, kredinë e marrë në shumën 1.000.000 lekë, në “Raiffeisen Bank”.

1.10 Komisioni hetoi edhe lidhur me gjendjen e konfliktit të interesit. Për këtë është mbajtur korrespondencë edhe me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit, të cilat në

³⁵Vjen si diferencë mes gjendjes së likuiditeteve në datën 10.8.2007, të cilat janë në vlerën 9.388,8 lekë dhe gjendjes së likuiditeteve në datën 31.12.2005, të cilat kanë qenë në vlerën 1.091.235,55 lekë.

³⁶Vjen si diferencë mes gjendjes së likuiditeteve në datën 11.6.2008, të cilat janë në vlerën 1.102.065 lekë dhe gjendjes së likuiditeteve në datën 10.8.2007, të cilat kanë qenë në vlerën 9.388,8 lekë.

përgjigjet³⁷ e tyre, në asnjë rast nuk konfirmuan shqyrtimin e çështjeve, ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë qenë: shoqëria “****” sh.p.k. apo shtetasi TH.A (ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë). Në të tilla kushte, Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje. Komisioni ka hetuar edhe lidhur me ndonjë trajtim preferencial të mundshëm në favor të subjektit, lidhur me shumën e blerjes së kësaj pasurie. Për këtë i është referuar udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “k”, për vitin 2007”. Sipas këtij akti, rezulton se çmimi lekë/m², sipërfaqe shfrytëzimi për vitin 2007, për qytetin e Tiranës është 97.000 lekë/m². Apartamenti i blerë nga subjekti është me sipërfaqe 84.13 m². Duke u bazuar në çmimet referuese, rezulton se vlera e apartamentit është 8.160.610 lekë. Kjo vlerë është me e ulët nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është blerë në vlerën 70.000 euro ose 8.581.489 lekë. Pra, rezulton se apartamenti është blerë në vlerën 420.879 lekë, më shtrenjtë nga vlerat e tregut (8.581.489 – 8.160.610). Në të tilla kushte duket se vlera e cilësuar në kontratë për blerjen e kësaj pasurie nuk ka synuar trajtimin preferencial ndaj subjektit.

1.11 Në funksion të barrës së provës sipas pikës 1.9.16, subjekti ka paraqitur qëndrimin e tij, duke parashtruar se kjo pasuri është krijuar 6 vjet përpara emërimit të tij në detyrë dhe, po kështu, kohë përpara se të ishte subjekt deklarues, duke analizuar³⁸ edhe dispozitat ligjore kushtetuese, si dhe ligjin nr. 84/2016.

1.11.1 Ka rezultuar se subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim, sikurse gjatë hetimit kur është pyetur për konstatimin e rrethanave që passillnin balancën negative, duke theksuar parashikimin kontraktor mbi detyrimet e ndërtuesit, lidhur me punimet që do të kryente të cilat janë bërë rreth muajit korrik 2008, prandaj edhe tërheqja e kësaj shume në bankë është bërë në datën 31.7.2008, pra, pasi shoqëria ndërtuese ka kryer punimet, ku edhe është likuiduar totalisht ndërtuesi. Sipas subjektit vlera 8.400 euro për blerjen e këtij apartamenti si këst i fundit ka qenë gjendje në bankë, mbajtur si garanci, derisa ndërtuesi të realizonte edhe punimet e premtuara dhe të rëna dakord.

1.11.2 Ka pretenduar dhe kërkuar prej Komisionit rishikimin e analizës financiare, pasi sipas tij është zbritur gabimisht dy herë vlera prej 28.000 euro, si në vitin 2006 dhe në vitin 2007, por nëse kryhet diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara në këto vite, rezultojnë se të ardhurat janë më se të mjaftueshme për blerjen e banesës, duke depozituar edhe një raport të ekspertit kontabël, ku përshkruhen të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit, si dhe referohen/prendohet edhe për gjendje *cash* në fund të çdo viti për periudhën e analizuar. Gjithashtu, në datën 4.7.2022, subjekti depozitoi edhe shkresën nr. *** prot., datë 27.6.2022, të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, e cila konfirmon se bashkëshortja e subjektit ka përfituar pagesë papunësie, për periudhën 23.7.2013 – 23.7.2014.

1.11.3. Lidhur me konstatimin e Komisionit për mungesë dokumentacioni, lidhur me pagesat e kryera për likuidimin e apartamentit, si dhe për të provuar destinacionin e kredisë së marrë në “Tirana Bank”, në vitin 2008, subjekti ka parashtruar se shumat e kësteve të kredisë së marrë për qëllime të blerjes së apartamentit, janë tërhequr /kryer pjesë -pjesë, porse kjo tërheqje është kryer sipas kërkesës që ndërtuesi ka pasur për shkak të nevojave të tij. Sipas subjektit kjo kredi, me qëllim blerje apartamenti, i cili, po ashtu, është lënë kolateral, është një marrëdhënie e cila do të vazhdojë edhe për 12 vjet të tjera, deri në momentin e heqjes së kufizimit hipotekor nga banka. Përgjatë kësaj periudhe të analizuar, subjekti ka parashtruar se nuk ka krijuar asnjë

³⁷Shkresë nr. *** prot., datë 20.4.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; shkresë nr. *** prot., A.K., datë 25.3.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; si dhe shkresë nr. *** prot., datë 15.4.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

³⁸Sipas subjektit, në interpretim të dispozitave ligjore, ai nuk mund të merret në analizë në këndvështrim të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, të cilat marrin kuptim vetëm në kuadër të personave që ushtrojnë funksionin e gjyqtarit apo prokurorit, pra, nga momenti i hyrjes në fuqi e për të ardhmen, jo për të shkuarën.

pasuri tjetër të paluajtshme në emrin të tij apo të personave të lidhur, që mund të vendosë në dyshim destinacionin e shumave të marra nëpërmjet kredisë.

1.11.4 Lidhur me konstatimet e Komisionit, se dukej se shuma 1.000 euro nuk është paguar me burim krijimi kredinë të marrë në “Tirana Bank”, pasi vetëm 41.000 euro janë tërhequr dhe jo 42.000 euro, sipas kontratës së porosisë, ka shpjeguar se i është referuar edhe momentit të deklarimeve, si dhe mund të ketë qenë një lapsus i tij saktësimi në mënyrë të detajuar i çdo tërheqje, por ka theksuar se kjo shumë është gjendje dhe akumulim i shumave të kursyera përgjatë asaj periudhe, shuma të cilat kanë burim krijimi të ardhurat e tij dhe familjes së tij, ndër vite.

1.11.5 Në lidhje me konstatimin e Komisionit, se dukej se me veprimet e tij kontraktore kishte favorizuar shoqërinë ndërtimore në shlyerjen e detyrimeve tatimore ndaj shtetit, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim, sikurse edhe gjatë hetimit, ndaj vlerësohet të mos bihet në përsëritje.

1.11.6 Lidhur me konstatimin e Komisionit, se dukej se subjekti nuk kishte deklaruar në DPV-në e vitit 2012, kredinë e marrë në shumën 1.000.000 lekë në “Raiffeisen Bank”, subjekti ka parashtruar se në momentin e deklarimit kjo kredi ishte shuar dhe sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, zyrtari publik kishte detyrimin për deklarimin e atyre detyrimeve që ekzistonin në atë moment.

Analiza e provave dhe fakteve dhe arsyetimi i tyre në raport me ligjin e zbatueshëm

1.12 Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit administrativ, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, parashtrimeve të tij në prapësime, por edhe provave të depozituara në funksion të barrës së provës, arsyeton si vijon:

1.12.1 Pavarësisht konstatimit të Komisionit apo pretendimit të subjektit se pasuria objekt shqyrtimi është e vetmja pasuri e paluajtshme që zotëron e përfituar përpara emërimit të tij në detyrë, trupi gjykues çmon se ajo është objekt kontrolli si një pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting*³⁹ dhe, më tej, vlerësohet në raport me gjendjen faktike të çështjes. Lidhur me barrën e provës, trupi gjykues, në kushtet që kontrata e shitjes në kuptim të nenit 690 të Kodit Civil, si dhe nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, përbën provë mbi vullnetin e palëve si akti final i regjistrimit të pasurisë që kryhet vetëm pasi çmimi është paguar, çmon se në analizën financiare nuk mund të përfshijë në përlllogaritje tërheqjet e kredisë pas nënshkrimit të kontratës së shitjes. Po ashtu, në kushtet e mosprovueshmërisë me dokumentacion të pagesave, si dhe destinacionit të kredisë pas nënshkrimit të kontratës, çmon se balanca negative në shumën 1.263.387 lekë, nuk ndryshon. Në këtë drejtim, trupi gjykues konstaton se edhe në variantin e pretenduar nga subjekti në seancën dëgjimore, *se shuma e kredisë së pa tërhequr ishte mbajtur si garanci për punimet dhe deri sa është regjistruar pasuria*, duke përlllogaritur vetëm shumën prej 4.500 euro të tërhequr në datën 13.6.2008, kohë kur është bërë dhe regjistrimi i pasurisë në hipotekë, balanca negative rezulton në shumën 709.066 lekë.

³⁹ Sipas parashikimeve të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i vlerësimit për kriterin e pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Sipas pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar”) që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, formulari i deklaratës *vetting*, shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016, në faqen 5, përcakton detyrimin për deklarimin e të gjitha pasurive të akumuluar ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

1.12.2 Në konkluzion, në vlerësimin tërësor të çështjes, se: (i) kjo pasuri është një pasuri e krijuar para detyre; (ii) nga hetimi, nuk doli ndonjë fakt apo provë që të provonte se kredia ka pasur një destinacion tjetër përveçse qëllimit të përcaktuar në kontratën e kredisë, *për blerje apartamenti*; (iii) nga hetimi nuk konfirmohet pasuri apo të drejta reale të tjera në emrin të subjektit apo të personave të lidhur me të; (iv) si shoqëria ndërtimore dhe subjekti pranojnë që likuidimi i pagesave është bërë me vonesë, përtej datës së nënshkrimit të kontratës; (v) afati kohor nga momenti i nënshkrimit të kontratës së shitjes deri në tërheqjen e fundit të kredisë është kryer brenda një muaji, trupi gjykues, proporcionalisht, çmon se kjo balancë nuk ka një peshë të tillë që mund të cenojë mjaftueshëm kriterin e pasurisë.

1.12.3 Lidhur me konstatimin e Komisionit, se dukej se subjekti nuk kishte deklaruar në DPV-në e vitit 2012, kredinë e marrë në shumën 1.000.000 lekë, në “Raiffeisen Bank”, në raport me shpjegimin e subjektit se në momentin e deklarimit kjo kredi ishte shuar dhe, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, zyrtari publik kishte detyrimin për deklarimin e atyre detyrimeve që ekzistonin në atë moment, trupi gjykues, nisur nga fakti që kjo kredi konfirmohet se ishte shlyer prej subjektit përpara deklarimit para fillimit të detyrës, nuk evidenton ndonjë problematikë.

1.12.4 Lidhur me konstatimin e Komisionit, se dukej se subjekti me veprimet kontraktore kishte favorizuar shoqërinë ndërtimore në shlyerjen e detyrimeve tatimore, trupi gjykues vlerëson se ky veprim i ndodhur nuk është korrekt, por proporcionalisht me kohën kur është kryer, pasi nuk ka qenë subjekt, por edhe për rrethanat dhe rezultatet e tjera ekzistenciale të hetimit, nuk ka peshë të tillë që të sjellë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

2. Automjet, tip “**”, me targa ***, viti i prodhimit 2004, me naftë, blerë në shumën 4.500 euro, sipas kontratës me nr. ***, datë 18.10.2013, shumë e siguruar nga shitja e automjetit të mëparshëm.** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁰.

2.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.

Faktet e rezultuara nga hetimi për këtë pasuri

2.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në DPV-në e vitit 2013, me përshkrimin: *“Pakësim të ardhurash nga blerje makinë tip ‘****’, me targa ***, të vitit 2004, por pavarësisht kontratës nuk është hedhur akoma në emrin tim, makina është blerë. Vlera: 4.500 euro”*.

2.2.i Po në këtë rubrikë, subjekti ka deklaruar: *“Shtim të ardhurash nga shitje makine tip ‘****’, me targa gjermane ***, e vitit 2002, me doganë, e blerë para datës 4.6.2012. Vlera: 6.000 euro”*.

2.3 DPSHTRR-ja⁴¹ konfirmon se subjekti rivlerësimi ka të regjistruar në pronësi të tij mjetin me targa ***. Kjo drejtori ka depozituar kontratën e shitblerjes automjeti tip “****” nr. ***regj., nr. *** kol., datë 18.10.2013, me palë blerëse Leonard Filopati dhe palë shitëse A.P. Vlera e mjetit: 4.500 euro.

2.4 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie

2.4.i Subjekti deklaroi në deklaratën *Vetting* se burim i kësaj pasurie është *shitja e makinës së mëparshme*.

⁴⁰(i) Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 18.10.2013, nënshkruar ndërmjet palës shitëse A.P dhe palës blerëse Leonard Filopati, të automjetit tip “****”, me targa ***, vit prodhimi 2004, kundrejt vlerës 4.500 euro, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale; dhe (ii) kontratë shitjeje nr. ***, datë 2.10.2013, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Leonard Filopati dhe palës blerëse R.XH, të automjetit tip “****”, me targa ***, kundrejt vlerës 6.000 euro, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale (Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴¹Referohuni shkresës nr. *** prot., datë 13.5.2020, në dosjen e Komisionit, si dhe Aneks nr. 30 në dosjen e ILDKPKI-së.

2.4.ii Subjekti e ka deklaruar për herë të parë automjetin tip “***”, në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2012, me përshkrimin: “*Makinë tip ‘***’ në emrin tim, vit prodhimi 2002, blerë në vitin 2012, në shumën 2.400 euro, blerë me të ardhurat familjare. Makina aktualisht është me targa gjermane ****”.

2.4.iii Nga aktet e administruara vërehet se subjekti nuk ka depozituar kontratë për blerjen e këtij automjeti në Gjermani, por ka deklaruar⁴² se ka *dashur të theksoj se me sa kujtonte blerjet e automjeteve në Gjermani me shumën nën vlerën 3.000 euro, në atë kohë, bëheshin pa kontratë shitblerje, por shkëmbim mes palësh dhe, më pas, te zyrat e tyre shtetërore pagim taksash, kontroll fizik, etj.* Referuar dokumentacionit të depozituar⁴³ rezulton se automjeti është zhdoganuar në datën 5.4.2013 dhe se vlera e automjetit është 250.000 lekë dhe detyrimi doganor i paguar nga subjekti është në vlerën 54.328 lekë.

2.4.iv Rezulton se ka mospërputhje midis vlerës së deklaruar nga subjekti për blerjen e automjetit tip “***”, në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2012, me vlerën e parashikuar në dokumentacionin doganor.

2.4.v Komisionit i rezulton se automjeti tip “***” është shitur nga subjekti, me kontratën e shitjes nr.***, datë 2.10.2013⁴⁴, në vlerën 6.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale, dhe disa ditë më vonë, në datën 18.10.2013, subjekti ka blerë automjetin tip “***”, në vlerën 4.500 euro.

2.4.vi Gjithashtu, Komisioni ka kërkuar nga subjekti⁴⁵ nëse është paguar tatimi mbi fitimin, nga diferenca e çmimit të shitjes me atë të blerjes së automjetit tip “***” (6.000 euro - 2.400 euro) dhe depozitimim e dokumentacionit përkatës. Subjekti ka sqaruar se për këtë automjet kishte bërë disa shpenzime dhe e kishte shitur referuar vlerës së tregut për atë kohë, ndërsa lidhur me pagesën e tatimit ka sqaruar, ndër të tjera, se: “*Lidhur me konstatimin tuaj për pagimin e tatimit mbi fitimin, në dijeninë time ligji mbi shitjen e automjeteve në kohën kur është shitur ky automjet nuk kishte tatim mbi fitimin, por kishte një pagesë që bëhej tek noteri në momentin e shitjes dhe që lidhej me vlerën e shitjes dhe kjo tarifë mbahej nga noteri*”, si dhe i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, duke depozituar edhe përgjigjen zyrtare të tyre⁴⁶. Referuar përgjigjes, subjekti ka pretenduar se: “*Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë ka sqaruar se referuar ligjit të kohës individi privat në rastin konkret unë, nuk paguante dhe nuk kishte detyrim ligjorë për pagim në burimi (tatim fitimi) mbi vlerën e shitjes së automjetit, për rrjedhojë nuk ka vend për keqinterpretim*”. Komisioni kreu analizën për të parë mundësitë financiare të subjektit për të investuar në këtë blerje, duke marrë në konsideratë si të ardhura të ligjshme nga shitja e automjetit vetëm shumën e shpenzuar për blerjen e tij. Sipas deklaratimit të subjektit ka shpenzuar 2.400 euro dhe 54.328 lekë për zhdoganimin e tij. Analiza është kryer vjetore meqenëse subjekti rezulton të ketë pasur gjendje *cash* nga viti kaluar.

Tabela nr. 4

Nr.	Përshkrimi	Viti 2013
1	TË ARDHURA	1,979,435

⁴²Pyetësor nr. 2, datë 28.2.2022.

⁴³Shkresë nr. *** prot, datë 8.3.2022, e Degës së Doganës Durrës, ku bashkëlidhur ndodhen: deklarata doganore datë 5.4.2013; mandatarëkëtimi me nr. serie ***, datë 5.4.2013; certifikata e regjistrimit të mjetit në gjermanisht, ku evidentohet shtetasi Leonard Filopati, adresa e tij në Shqipëri dhe data 30.4.2012; dhe vërtetim notarial nr. *** rep., datë 5.4.2013, për librezën e mjetit, depozituar në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 28.2.2022.

⁴⁴Aneksi nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁵Pyetësor nr. 2, datë 28.2.2022.

⁴⁶Shkresë nr. *** prot., datë 7.3.2022, nga ku rezulton se pas një interpretimi të nenit 8 “E ardhura e tatueshme”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ky institucion në përfundim deklaroi se: “*Të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së luajtshme (në rastin tuaj autoveturë/dhe ose mjet motorik) nuk janë të ardhura të listuara në nenin 8 ‘Të ardhura të tatueshme’, si dhe pikën 2.3 të udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006 (i ndryshuar) në zbatim të dispozitave ligjore*”.

	Të ardhura nga paga subjekti	840,536
	Të ardhura nga paga bashkëshortja	749,216
	Të ardhura nga interesat	26
	Të ardhura nga shitja e automjetit tip “****”, me targa ***	389,656
2	SHPENZIME	1,258,023
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	564,096
	Shpenzime kredia (“Tirana Bank”) (komisione + sig.prone + sig.jete)	18,518
	Shpenzime kredia (“Tirana Bank”) (principal+interes)	438,371
	Shpenzime për zhdoganimin e automjetit, me targa ***	54,328
	Shpenzime transporti Tiranë-Mat-Tiranë	22,000
	Blerje <i>online</i>	160,711
3	PASURI	688,006
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Automjet tip “****”, me targa ***	630,945
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	57,061
	DIFERENCA (1-2-3)	33,405

Komisioni, nga përlllogaritjet financiare të kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, për këtë pasuri, konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë në pasurinë e luajtshme automjet, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare dhe, për rrjedhojë, çmoi se subjekti ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie.

DETYRIME FINANCIARE

3. Kredi marrë në “Tirana Bank”, për blerje apartamenti me sip.84 m², tek rruga “****” kati *** Tiranë, me kontratën nr.***, datë 21.04. 2008, me afat 25-vjeçar dhe me interes vjetor 2.9% + *euribond* dhe aktualisht kësti mujor shkon rreth 245 euro/muaj, nga të cilat rreth 130 euro principal dhe rreth 115 euro interesi. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer rreth 38.128 euro. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁷.

3.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Tirana Bank”.

3.2 Komisioni ka konstatuar se kjo kredi është deklaruar nga subjekti në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2012 me qëllim blerjen e apartamentit të trajtuar në pasurinë nr. 1.

“Tirana Bank”⁴⁸ informoi mbi kredinë në shumën 50.000 euro dhe nga *statement* rezulton se detyrimi i mbetur deri më 26.1.2017 është në shumën 38.128,35 euro, duke konstatuar se deklarimi i subjektit përputhej e me përgjigjen e ardhur nga “Tirana Bank”.

Lidhur me deklarimin e pasurive të bashkëshortes së subjektit

4. Ka rezultuar se personi i lidhur me subjektin ka deklaruar kredi marrë nga bashkëshorti në “Tirana Bank”, për blerje apartamenti me sipërfaqe 84 m², të ndodhur në rrugën “****”, kati ***, Tiranë, me kontratën nr.***, datë 21.04. 2008, me afat 25-vjeçar dhe me interesa vjetore 2.9% + *euribond* dhe aktualisht kësti mujor shkon rreth 245 euro/muaj, nga të cilat rreth 130

⁴⁷Vërtetim nr. *** prot., datë 23.1.2017, nga “Tirana Bank” për shtetasit Leonard Filopati dhe B.H, të cilët janë klientë kredimarrës pranë bankës, me limit 50.000 euro dhe detyrim të pashlyer në shumën 38.128,35 euro (Aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2020.

euro *principal* dhe rreth 115 euro interesi (*kopje kontrate*). Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer aktualisht rreth 38.128 euro.

4.1 Komisioni, në kushtet që kjo kredi është trajtuar më lart në deklarinimin e subjektit, çmon të mos bjerë në përsëritje.

5. Përdorim i kartës “Prima” në BKT (vërtetim banke). Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer rreth 55.000 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁹.

5.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.

5.2 BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 28.5.2020, informon se znj. B.F ka produktin *kartë krediti me limit* 150.000 lekë.

5.3 Komisioni ka konstatuar se nga aktet e administruara në dosje dhe verifikimi i tyre përputhen deklarinimet e personit të lidhur dhe, për rrjedhojë, nuk i rezultuan problematika.

6. Komisionit, nga korrespondenca e me institucionet publike⁵⁰ si: AMF, Policia e Shtetit për hyrje-daljet, Ministria e Drejtësisë, për regjistrin noterial, nuk i kanë rezultuar problematika apo dyshime për përdorim automjetesh, dalje në *TIMS* me mjete të padeklaruara apo kontrata të nënshkruara pranë noterit publik nga dhe në adresë të subjektit të rivlerësimit, përveçse atyre të identifikuar gjatë hetimit. Për mjetet me të cilat rezulton të ketë dalë jashtë territorit të vendit, Komisioni ka kryer hetim⁵¹, si dhe ka pyetur subjektin, ku po ashtu nuk ka konstatuar parregullsi.

7. Lidhur me të ardhurat e subjektit nga punësimi përpara vitit 2005

7.1 Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar të ardhura për periudhën përpara vitit 2005, përkatësisht: (a) shef kontrolli te gazeta “****”, nga 1.1.1995 – dhjetor 1997 dhe dhjetor 1997 – 1.12.1998 ka punuar si *** (“****”), ku paguhej me rrogë mujore (nuk i kujtohet saktë), por ka qenë shumë më lart se rroga maksimale e kohës. Për shumat e cituara në punët private nuk i disponon të gjitha, pasi dokumentet në gazetën “****” janë djegur, por disponon të ardhurat e deklaruar nga “****” sh.p.k.; (b) menaxher reklamash dhe shef marketingu tek “****”, TV *** si ***, tek TV *** nga 1.1.1998 - 1.8.2005 të ardhurat e subjektit ishin me % dhe nuk i kujtohej saktë, por ka qenë shumë herë më e lart se rrogat maksimale të kohës, ku subjektet private ku punonte i mbanin tatim 10% mbi të ardhurat e krijuara nga % e fitimit për shumat e reklamave të arkëtuara. Gjithashtu, ka qenë aksioner me rreth 20% të aksioneve tek “****” (TV *** dhe Radio ***), kontrata të cila nuk i disponon, por ato janë të pasqyruar në ish-QKR, kur dhe janë shitur aksionet rreth vitit 2000. Subjekti aksioner tek TV *** dhe Radio *** është bërë bazuar në të ardhurat e krijuar nga kontributi te këto media, si *** dhe *** i marketingut të tyre, nga 1998 deri kur janë shitur aksionet në vitin 2000.

7.2 Vlera e të ardhurave nuk provohet më dokumentacion, por subjekti është përpjekur gjatë hetimit të depozitohet prova indirekte për të provuar punësimin e tij.

⁴⁹Vërtetim nr. *** prot., datë 26.1.2017, lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare për znj. B.F, e cila është kliente e bankës dhe ka një kartë krediti me limit 150.000 lekë, çelur në datën 14.4.2016. Detyrimi i kartës deri më 26.1.2017 në shumën 55.847,65 lekë (Aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵⁰Shkresë nr. *** prot., datë 4.6.2020 nga AMF-ja; shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; si dhe shkresë nr. *** prot., datë 18.5.2020, nga Ministria e Drejtësisë.

⁵¹Shkresë nr. *** prot., datë 9.5.2022 nga DPSHTRR-ja, shkresë nr. *** prot./A.M datë 13.5.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; shkresë nr. *** prot., (R.J) datë 19.5.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., A.K. datë 18.5.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresë nr. *** prot., datë 20.5.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

7.2.i Subjekti ka depozituar shkresë⁵² nga subjekti gazeta “****”, e cila konfirmon marrëdhënien e punësimit si menaxher reklamash dhe si drejtor marketingu te shoqëria “****” sh.a. (Televizioni ***, gazeta “****”, radio “****”), në periudhën 1998 – 2005.

7.2.ii Kjo shoqëri ka sqaruar në shkresën e saj se kanë kaluar 24 vjet dhe nuk disponon të dhëna arkivore, por informon se menaxherët e reklamave nuk merrnin rrogë fikse, por merrnin përqindje mbi reklamat e arkëtuara prej tyre, që në atë periudhë ishte 20-25% në varësi të shumës së arkëtuar. Nga kjo përqindje mbi reklamat, që përfitonin menaxherët dhe drejtori u marketingut, kësaj shume i zbritet 10% për pagesat e detyrimeve tatimore, shumë e cila mbahej në moment nga financa përkatëse e gazetës “****” apo financa e shoqërisë “****” sh.a. (Televizioni ***, gazeta “****”, Radio “****”).

7.2.iii Gjithashtu, subjekti ka vendosur në dispozicion⁵³ kopje gazetash “****”, ku identifikohet emri i tij, Leonard Filopati dhe nr. kontaktit si *** reklame.

7.2.iv Ka depozituar fatura tatimore shitje⁵⁴ për reklama të lëshuara nga subjekti “****”, për subjekte të tjera tregtare, ku në secilën faturë ka firmosur Leonard Filopati. Faturat datojnë 2002-2003. Totali i tyre është në vlerën 2.562.140 lekë. Nëse e konsiderojmë fitimin prej 20%, sipas deklaramit të administratorit të “****” dhe pas zbritjes së detyrimit tatimor (tatim në burim) prej 10% atëherë rezulton se fitimi i realizuar nga këto fatura është në vlerën 461.185 lekë⁵⁵.

7.2.v Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2022, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, e cila informon se për periudhën 1998 – 2005, nga verifikimi i dosjes fizike, konstatohet se shoqëria “****” ka deklaruar në pasqyrat financiare të ardhura nga shitja e gazetës, si dhe të ardhura nga reklamat. Gjithashtu, në zërin shpenzime ka deklaruar honorare, trajtime e të tjera. Rezulton se ka mandatpagesa për tatimin në burim, por nga ana tjetër është e pamundur identifikimi se për kë është derdhur ky detyrim tatimor.

7.3 Si shoqëria “****” edhe DPT-ja deklarojnë se është përgjegjësi e tatimpaguesit apo e financës së shoqërisë mbajtja e pagesave të tatimit në burim dhe jo i personit.

7.4 Nisur nga këto kushte, ku nuk mund të përcaktohet shuma e saktë e përfituar nga punësimi, Komisioni ka vlerësuar që analiza e subjektit përpara fillimit të detyrës, viti 2012 të jetë akumulative nga viti 2006 – 2012 edhe për faktin se në vitin 2012, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 500.000 lekë si rezultat i kursimeve të tij në vite dhe pas vitit 2012 e detajuar për çdo vit deklarimi. Nuk janë përfshirë në këtë analizë të ardhurat nga punësimi për bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, për periudhën 2009 – 2011, pasi nuk është provuar shuma e përfituar, si dhe në përputhje dhe në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Tabela nr. 5

Nr.	Përshkrimi	2006 – 2012	2014
1.	TË ARDHURA	14,696,619	1,710,888
	Të ardhura nga paga subjekti	4,577,857	1,076,872
	Të ardhura nga paga bashkëshortja	632,271	633,998

⁵²Pyetësor nr. 2, datë 28.2.2022.

⁵³Pyetësor nr. 2, datë 28.2.2022.

⁵⁴Depozituar me pyetësorin nr. 4, datë 23.3.2022.

⁵⁵2.562.140 lekë x 20% - 10%.

	Kredi "Tirana Bank" (2008), në vlerën 50.000 euro	6,159,125	-
	Kredi "Raiffeisen Bank" (2006)	1,000,000	-
	Të ardhura nga interesat	8,206	18
	Të ardhura nga shitja e apartamentit sip.60 m ² (më 24.3.2006)	1,900,000	-
	Të ardhura nga shitja e mjetit tip "****", me targa *** (më 22.2.2012)	419,160	-
2.	SHPENZIME	6,261,062	1,926,900
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	2,241,847	879,992
	Shpenzime kredia (RFZ) (principal+interes)	1,258,134	-
	Shpenzime kredia ("Tirana Bank") (komisione + sig.prone + sig.jete)	183,569	21,017
	Shpenzime kredia ("Tirana Ban") (principal+interes)	2,135,036	430,126
	Shpenzime transporti Tiranë-Mat-Tiranë	12,000	22,000
	Shpenzime TIMS	330,476	392,308
	Blerje online	-	181,457
	Shpenzime mobilimi	100,000	-
3.	PASURI	8,905,989	25,169
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme		
	Ap. sip.84 m ² (***) (2008)	8,581,489	-
	Automjet tip "****", me targa *** (2012), blerë para datës 4.6.2012, emërimi	335,328	-
	Automjet tip "****", me targa *** (më 4.6.2008)	500,000	-
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	(510,828)	25,169
	DIFERENCA (1-2-3)	-470,432	-241,181

7.5 Lidhur me analizën për vitet 2006 – 2012, ku subjekti ka rezultuar në balancë negative në shumën 470.332 lekë, trupi gjykues konstaton se subjekti ka provuar të ardhura të bashkëshortes, duke depozituar dokumentacion, si vërtetim nr. *** prot., datë 22.6.2022, nga ISSH-ja, ku vërtetohet se bashkëshortja është trajtuar me raport barrë lindje për periudhën 15.9.2008 – 15.9.2009 dhe për periudhën 27.8.2012 – 23.07.2013, si dhe shkresën nr. *** prot., datë 27.6.2022, të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, e cila konfirmon se bashkëshortja B.F ka përfituar pagesë papunësie, për periudhën 23.7.2013 – 23.7.2014. Pas rilloaritjeve, si rezultat i përfshirjes së kësaj shume, rezultati financiar negativ për vitet 2006 – 2012, nga 470.332 lekë është në shumën 214.502 lekë dhe për vitin 2014 nga 241.181 lekë është në shumën 194.837 lekë. Trupi gjykues përllogaritjet i ka kryer vetëm mbi bazën e dokumentacionit, ku është përcaktuar vlera e përfituar, si dhe që plotësojnë kriterin e pikës 3,

të nenit D të Kushtetutës. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues, lidhur me balancën e periudhës 2006 – 2012 (periudhë përpara emërimit në detyrë të subjektit, në vlerën 214.502 lekë) ka konstatuar se subjekti ka bërë përpjekje për të provuar punësimin e tij, duke depozituar prova indirekte, porse përmes tyre nuk përcaktohet masa e përfitimit. Nga ana tjetër, lidhur me të ardhurat e përfituara pranë gazetës “***”, subjekti ka provuar që ka qenë i punësuar pranë kësaj gazete, si dhe DRT-ja Tiranë⁵⁶ konfirmon se për shoqërinë “***” ka mandatpagesa për tatimin në burim, por është e pamundur identifikimi se për kë është derdhur ky detyrim tatimor. Në tërësi të këtyre konstatimeve, trupi gjykues vlerëson se balanca negative në masën e mbetur 214.502 lekë, merr çmuarje tërësisht proporcionale në këtë vendimmarrje.

7.6 Sa i përket pretendimit të subjektit që në shpenzimet e jetesës të zbriten nga analiza financiare “zëra të shpenzimeve”, të cilat *dublikohen* dhe janë të përfshira njëkohësisht edhe në kategoritë e klasifikimit të konsumit individual, trupi gjykues, në ndryshim nga pretendimi i subjektit, nga hetimi në tërësi, ka konstatuar përpjekje të këtij të fundit për të rritur cilësinë e jetesës, në drejtim të udhëtimeve dhe pushimeve jashtë vendit, blerjeve *online*, etj. Trupi gjykues, në këtë rast, nuk mundet të përcaktojë një vlerë të posaçme për shpenzimet e tij jetike, por vlerëson se për këto shpenzime, referuar INSTAT-it, duhet të merren në konsideratë vlerat që u përkasin shpenzimeve mesatare mujore për konsum për familje me 4 anëtarë, duke mos e marrë kështu në konsideratë pretendimin e tij. Po ashtu, trupi gjykues i qëndron të njëjtit vlerësim mbi analizën financiare, pasi pretendimi i subjektit, se është zbritur gabimisht dy herë vlera prej 28.000 euro, si në vitin 2006, ashtu edhe në vitin 2007, edhe pas riverifikimeve të Komisionit, vëren se ky pretendim nuk qëndron.

7.7 Në konkluzion, trupi gjykues çmon se rrethanat e konstatuara në pasurinë e krijuar para detyrës në masën dhe peshën e tyre, proporcionalisht dhe objektivisht, në vlerësimin e kriterit të pasurisë, si dhe procesit në tërësi, nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm për aplikimin e ndonjë mase disiplinore, sipas parashikimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ndaj subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar për subjektin e rivlerësimit, Raportin mbi kontrollin e figurës nr. ***prot., datë 2.11.2017, të përditësuar dhe deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 9.12.2020, të KDZH-së, ku, në përfundim të veprimeve verifikuese, Grupi i Punës ndryshoi konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga *përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës* nga subjekti i rivlerësimit Leonard B Filopati. Në këtë raport, Grupi i Punës ka evidentuar edhe informacionin se për subjektin Leonard Filopati, në cilësinë e prokurorit, është dhënë masë dënimi “vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra” nga Këshilli Disiplinor në Prokurorinë e Përgjithshme në vitin 2015.

Hetimi i kryer nga Komisioni në kuadër të kontrollit të figurës

Komisioni ka kryer një hetim të pavarur, duke kërkuar informacion pranë organeve kompetente në lidhje me figurën, në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, ku nga hetimi nuk rezultuan

⁵⁶Nr. *** prot., datë 8.3.2022.

indicie në lidhje me kontakte të papërshtatshme të subjektit me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Më tej, në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfuara nga autoritetet verifikuese, Komisioni ka administruar disa dosje hetimore të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, të cilat pas shqyrtimit dhe analizimit të tyre, u konsideruan të lidhura me kriterin profesional dhe janë paraqitur të integruara në seksionin e kriterit profesional, referuar “Gjetje të tjera”. Për rrjedhojë, Komisioni i komunikoi subjektit se konkluzionet e raportit të kontrollit të figurës do të vlerësohen edhe në raport me çështje profesionale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në qëndrimin e tij, ndër të tjera, subjekti ka parashtruar se konstatimi i DSIK-së nuk është i saktë, është i pabazuar në ligj e prova, por është thjesht një opinion i tyre me qëllime jo ligjore. Sipas subjektit në konstatimet e saj, DSIK-ja, edhe pse fillimisht ka dhënë opinion pozitiv ndaj tij, në vijim e ka ndryshuar atë, me gjetje të vitit 2015, kur ato fakte i ka pasur si gjetje dhe fillimisht ka bërë raport pozitiv dhe, më pas, pa pasur asnjë gjetje të re, e ka ndryshuar raportin në vitin 2020, duke e lidhur dyshimin për veprimtari korruptive me faktin se Këshilli Disiplinor në Prokurorinë e Përgjithshme ka dhënë masë dënimi “vërejtje për shkarkim nga detyra”, për subjektin Leonard Filopati, në cilësinë e prokurorit, masë e dhënë në vitin 2015, që, për rrjedhojë, lehtësisht mund e duhej të ishin përfshirë në raportin e parë të përgatitur nga DSIK-ja.

Subjekti ka pretenduar se kjo gjetje e DSIK-së, nuk qëndron pasi Këshilli Disiplinor në Prokurorinë e Përgjithshme (organ këshillues dhe jo vendimmarrës) ka sugjeruar masën disiplinore “vërejtje” dhe jo “vërejtje për shkarkim nga detyra”, masë e cila në asnjë moment nuk është vendosur për shkak të dyshimeve korruptive, por për shkak të pretendimeve procedurale të Drejtuesit të Prokurorisë Mat, se nuk ishte marrë ciklimi prej tij tek akti procedural “diskutime përfundimtare” në 2-3 çështje në gjykim, një ndër to ishte edhe ajo e të pandehurit H.K. Pra, kjo masë disiplinore (*është shprehur subjekti*) lidhej me raportin tim dhe debatet me Drejtuesin e Prokurorisë Mat.

Subjekti ka parashtruar se Komisioni nuk duhet të anashkalojë faktin se masa disiplinore “vërejtje” e propozuar nga një organ kolegjal si Këshilli Disiplinor, çuditërisht është ndryshuar nga një organ monokratik si Prokurori i Përgjithshëm, duke e rënduar pozitën e tij me një masë më të rëndë si ajo “vërejtje me paralajmërim”. Në dhënien e kësaj mase disiplinore, sipas subjektit, rol ka pasur edhe përjasja negative personale e Drejtuesit të Prokurorisë Mat, për shkak të konflikteve që kanë pasur përgjatë periudhës së emërimit të tij në këtë prokurori, përfshirë edhe raste të debatit me një kolege tjetër, lidhur me një çështje penale⁵⁷ që hetonte, për të cilën, subjekti ka parashtruar komunikime/debate mes tyre dhe në kushtet që dy kolegët e tjerë e kritikuan drejtuesin për presionin e hapur dhe gjuhën e përdorur, subjekti kishte paraqitur kërkesën për përjashtimin e tij nga kjo çështje. Sipas subjektit kjo kërkesë nuk ishte pranuar nga drejtuesi i prokurorisë dhe, për rrjedhojë, ka paraqitur ankesë te Prokurori i Përgjithshëm i kohës, i cili kishte vendosur: (a)*mospranimin e ankimit të prokurorit të çështjes Leonard Filopati (subjekti) ndaj vendimit të datës 26.4.2013, të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat “Për mospranimin e kërkesës për heqje dorë nga hetimi i çështjes”;*(b)*zëvendësimin e prokurorit Leonard Filopati me prokurorin, njëkohësisht drejtues i Prokurorisë A.M, në procedimin penal nr. ***, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat.* Subjekti ka vijuar me parashtrimin e rrethanave të raportit që ka pasur me drejtuesin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, duke konkluduar se informacioni i përcjellë nga DSIK-ja nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016, prandaj konsiderohet i paplotë.

⁵⁷Referuar procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 16.11.2012.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit, në kushtet që nga hetimi i kryer nga Komisioni: (i) nuk u konstatuan mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave në këtë deklaratë nga subjekti i rivlerësimit; (ii) nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të jetë përfshirë në veprimtari të paligjshme apo të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (iii) pas analizimit të çështjeve të trajtuara në drejtim të aspektit profesional, si më poshtë arsyetohet, nuk rezultuan elemente të tillë që provuan fakte që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer veprime që bien në kundërshtim me ligjin procedural dhe material; (iv) bazuar në hetimin e Komisionit, rezultoi se nuk ka pasur asnjë ankesë, asnjë kontakt, asnjë telefonatë, asnjë fotografi, asnjë procedim penal, asnjë kallëzim apo mosfillim ndaj tij, përgjatë viteve 2005 – 2022, arrin në përfundimin se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së mbeten të paprovuara, dhe se konstatimet e vlerësuara në kriterin profesional nuk evidentuan elemente të tillë, që mund të meritojnë një vlerësim që cenon këtë kriter apo vlerësimin tërësor të procesit për këtë subjekt.

Nën këto konstatime, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Leonard Filopati ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të gurmës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti⁵⁸ për analizimin e aftësive profesionale është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) *aftësitë profesionale;*
- b) *aftësitë organizative;*
- c) *etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;*
- ç) *aftësitë personale dhe angazhimi profesional.*

Në raportin e tij, organi ndihmës, lidhur me këtë kriter, ka konstatuar sa referohet:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Prokurori Leonard Filopati tregon korrektësi në zbatimin të ligjit. Në tri aktet procedurale ligjore të paraqitura prej tij dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme pothuajse në të gjitha rastet. Në përgjithësi analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit. Është konstatuar se subjekti ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur, në respektim të

⁵⁸Nr. *** prot., datë 8.7.2020, miratuar me vendimin nr. ***, datë 8.7.2020, të KLP-së.

dispozitave procedurale penale dhe urdhrit nr. 174, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”. Aktet e përpiluara prej tij janë administruar në sekretarinë e prokurorisë, në respektim të plotë të urdhrit. Rezulton se qëndrimet e Prokurorit Përgjithësisht janë mbështetur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

b) Arsyetimi ligjor

Prokurori Leonard Filopati shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij janë të kuptueshme. Nga pikëpamja gjuhësore, ka respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej tij. Konstatohet se në aktet e përpiluara prej tij nuk përdoret germat “ë” dhe “ç”.

Aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit janë të konceptuara përgjithësisht me tri pjesë. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Në përmbajtjen e tyre (akteve) formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori. Rezulton se konkluzioni i prokurorit, në aspektin arsyetues, lidhur me konstatimin e faktit penal, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf në dosjet 1, 2, 3 dhe 4. Ndërsa në dosjen 5 dhe dokumentin 3 rezulton se prokurori ka analizuar me hollësi elementët e veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehuri.

Subjekti i rivlerësimit në përgjithësi ka analizuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mënyrën e caktimit të dënimit në dosjen 5. Prokurori Leonard Filopati në dokumentin 3, ka analizuar me hollësi rrezikshmërinë e veprave penale objekt gjykimi, rrezikshmërinë e autorit, si dhe janë përshkruar rrethanat lehtësuese dhe rrethanat rënduese në funksion të masës së dënimit të kërkuar. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer kryesisht detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Nga marsi 2016 – tetor 2016, prokurori Leonard Filopati ka ushtruar detyrën e inspektorit në Ministrinë e Drejtësisë.

Nga të dhënat statistikore, sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 30.1.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, rezulton se subjekti i rivlerësimit Leonard Filopati ka trajtuar në këtë institucion gjithsej 364 çështje. Ngarkesa dhe saktësia e statistikave të subjektit të rivlerësimit pasqyrohet në vërtetimin e mësipërm të lëshuar nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, si dhe tabelat e administruara, sipas procesverbalit “Për pasqyrimin e veprimeve të përzgjedhjes së 5 dosjeve për subjektin e rivlerësimit Leonard Filopati”, datë 5.2.2019.

Subjekti i rivlerësimit Leonard Filopati ka ushtruar kompetencat që ligji i njeh prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes të policisë gjyqësore. Prokurori ka kryer detyrat e tij në pajtim me pikën 2 dhe 2. 1 të urdhrit nr. 147, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Leonard Filopati, merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe disponimin e gjykatës.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga të dhënat e deklaruara nga prokurori Leonard Filopati konstatohet se për periudhën e rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Aktualisht ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Tiranë.

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Leonard Filopati, si dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në tri dokumentet e dorëzuara prej tij, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tre dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Leonard Filopati, i nënshtrohet Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, është deklaruar se është angazhuar në nëntë aktivitete profesionale (seminar) të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës. Lidhur me trajnime të tjera, të kryera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar në "Formularin e vetëvlerësimit profesional" se ka qenë pjesëmarrës në disa aktivitete të zhvilluara.

C/1 RIVLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE

A. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i KLP-së;

- Kriteret e vlerësimit të parashikuara në ligjin 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

1. Në lidhje me analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Komisionit, sikurse i ka rezultuar edhe Grupit të Punës në raportin e tij të vlerësimit, në tërësi duket se nuk i kanë rezultuar problematika në lidhje me hetimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit në të tri dokumentet ligjore, të llojit kërkesë për ekstradim, vendim pushimi të procedimit penal dhe konkluzione mbi çështjen penale, të përzgjedhura nga ky i fundit, si dhe në pesë dosjet e përzgjedhura me short, të llojit vendime pushimi ose mosfillimi të procedimeve penale, kërkesë për gjykim dhe kërkesë për caktim të masës mjekësore.

2. Në lidhje me pesë dosjet penale dhe dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, për të cilat subjekti në qëndrimin e tij shpjegoi se nuk ka pasur ankim.

3. Komisioni, në referim të pikës 4 të rubrikës “Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime”, më sipër, ka konstatuar se ndaj subjektit të rivlerësimit Leonard Filopati është marrë masë disiplinore “vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra” nga Prokurori i Përgjithshëm.

3.1 Në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme nuk janë administruar ankesa apo kallëzime ndaj subjektit të rivlerësimit.

GJETJE TË TJERA

a) Komisioni administroi fashikullin penal⁵⁹ që i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në datë 16.11.2012, në ngarkim të të pandehurit F.N, akuzuar për veprat penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese, mbetur në tentativë” dhe “mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 79/ë-22 dhe 278/2 të Kodit Penal. Nga aktet e administruara rezultoi si vijon:

Paraprakisht, Komisioni ka konstatuar se në këtë procedim penal janë angazhuar disa subjekte të tjera rivlerësimi (prokurorët A.M dhe A.N) bashkë me subjektin Leonard Filopati.

Nga të dhënat e administruara u vërejt se çështja i referohet një konflikti të ndodhur në datën 14.11.2012, në fshatin ***, të rrethit Mat, midis disa shtetasve.

Nga aktet e administruara u konstatua se Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër, Komisariati i Policisë Mat, me shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2012, i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, materialet procedurale që bëjnë fjalë për veprën penale të “vrasje me dashje në bashkëpunim mbetur në tentativë” dhe “armëmbajtje pa leje”, parashikuar nga nenet 76, 25, 22 dhe 278/2 të Kodit Penal, në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 14.11.2012, në fshatin ***, Komuna ***, rrethi Mat.

Me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, datë 16.11.2012, të një subjekti tjetër znj. A.N, prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat, është regjistruar procedimi penal nr. ***, i vitit 2012, për veprat penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/ë, 25 dhe 22 të Kodit Penal dhe “mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, ndaj shtetasve E.N dhe F.N.

⁵⁹Me shkresën nr. *** prot./A.M., datë 16.07.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat.

Në vijim, me urdhrin për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, datë 19.12.2012, po të kësaj prokurore, është regjistruar emri i personit që i atribuohet vepra penale, shtetasi F.N, i dyshuar për veprën penale “vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/ë e 22, të Kodit Penal dhe “mbajtjes pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Prokurorja A.N i ka pushuar hetimet në ngarkim të shtetasve E.N dhe F.N, me vendimin e datës 19.12.2012.

Me vendimin e datës 18.3.2013, të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, z. A.M, janë shfuqizuar vendimet e ndërmarra nga subjekti A.N dhe me urdhrin, datë 27.3.2013, është zëvendësuar kjo prokurore me subjektin e rivlerësimit.

Rezulton se subjekti në vijim ka kryer veprimet hetimore sipas urdhrin të drejtuesit të prokurorisë, konkretisht:

- i) në datën 2.4.2013 ka urdhëruar OPGJ-në për kryerjen e disa veprimeve hetimore;
- ii) ka lëshuar disa urdhra për thirrjen e shtetasve në prokurori;
- iii) në datën 17.4.2013 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit, nga “arrest shtëpie” në “arrest me burg”.

Rezulton se gjykata, me vendimin nr. ***, datë 23.4.2013, ka vendosur mospranimin e kërkesës. Në vijim, ndaj këtij vendimi është ushtruar apel nga drejtuesi i prokurorisë A.M.

Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit në datën 23.4.2013 ka bërë kërkesë për heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal⁶⁰, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë, me arsyetimin se *“nuk mund të jem i paanshëm në zgjidhjen e drejtë ligjore të kësaj çështjeje penale për shkak të ushtrimit të ndikimit që ka bërë drejtuesi i prokurorisë”*.

Me vendimin e datës 26.4.2013 “Për shqyrtimin e kërkesës me shkrim të prokurorit Leonard Filopati për mospranimin e heqjes dorë nga hetimi i çështjes”, drejtuesi i prokurorisë, ka arsyetuar se kërkesa e subjektit për heqje dorë nga hetimi për shkaqe të parashikuara nga nenet 26 dhe 27 të Kodit Procedurës Penale është e pabazuar në ligj.

Subjekti në datën 29.4.2013 i është drejtuar me shkresë drejtuesit të prokurorisë, ku ka evidentuar faktin që është njohur me vendimin e tij për shqyrtimin e kërkesës për heqje dorë dhe mospranimin e kërkesës dhe ka bërë me dije se do të paraqesë ankesë në prokurorinë më të lartë.

Në vijim, Komisioni konstaton se subjekti ka bërë ankim⁶¹ në lidhje me “vendimin për mospranimin e kërkesës për heqje dorë nga hetimi i çështjes penale”, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, i cili me shkresën nr. *** prot/A.P., datë 19.6.2013, ka dërguar dy vendime “Për shqyrtimin e ankimit të prokurorit ndaj vendimit të drejtuesit të Prokurorisë”, për këtë procedim.

Në vendimin “Për shqyrtimin e ankimit të prokurorit ndaj vendimit të drejtuesit të prokurorisë”, datë 11.6.2013, të Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me ankimin e subjektit ndaj vendimit të datës 26.4.2013, të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Mat, z. A.M, “Për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit Leonard Filopati, për heqjen dorë nga hetimi i çështjes”, është vendosur:

- Mospranimi i ankimit të prokurorit të çështjes Leonard Filopati (subjekti) ndaj vendimit, datë 26.4.2013, të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat “Për mospranimin e kërkesës për heqje dorë nga hetimi i çështjes”.

⁶⁰Referuar neneve 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale.

⁶¹Në datën 8.5.2013 ankim për shfuqizimin e vendimit të Drejtuesit të Prokurorisë, datë 26.4.2013, dhe pranimin e kërkesës për heqje dorë nga hetimi.

- Zëvendësimi i prokurorit Leonard Filopati me prokurorin, njëkohësisht, drejtues i prokurorisë, z. A.M, në procedimin penal nr. ***, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat.

Komisioni, në analizë të të gjithë veprimeve procedurale të ndërmarra nga subjekti, pavarësisht se nuk konstatoi ndonjë shkelje, në funksion të qartësimit më të plotë të kësaj shtetë, i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me këtë çështje.

Subjekti, ndër të tjera në qëndrimin e tij, ka sqaruar se ndryshimi i masës së sigurimit është bërë në përputhje me rrethanat e faktit, si edhe mbi dyshimet e arsyeshme lidhur me personat e dyshuar, bazuar, gjithashtu, në logjikën e vendimit të drejtuesit të prokurorisë, datë 18.3.2013, për të shfuqizuar vendimet e ndërmarra nga prokurorja A.N. Pas rrëzimit të kërkesës nga gjykata, drejtuesi i prokurorisë ka vendosur të paraqesë vet ankim, në vijim të qëndrimit të tij për këtë çështje penale prej periudhës që hetohet nga prokurorja e mëparshme znj. A.N, pas së cilës subjekti ka qartësuar se për shkak të sjelljes së drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Mat është shtyrë drejt paraqitjes së dorëheqjes nga hetimi i kësaj çështje penale.

Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe rrethanave të rezultuara në këtë çështje, vëren se subjekti ka kryer veprimet procedurale të urdhëruara edhe nga drejtuesi i tij, të cilat, më tej, janë kontrolluar edhe nga gjykata. Qëndrimi i subjektit, lidhur me dorëheqjen e tij nga vijueshmëria e hetimit të kësaj çështje dhe ndjekja e hapave të mëtejshëm ligjorë për ankimin ndaj vendimit të mospranimit të dorëheqjes, në raport me vlerësimin e tij subjektiv ndaj drejtuesit apo edhe çështjes në tërësi, nuk pasqyron problematika që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional apo tërësor të subjektit.

b) Komisioni administroi fashikullin penal që i përket procedimit penal nr.*, regjistruar në datën 3.9.2012, në ngarkim të të pandehurit F.J, akuzuar për veprat penale “dhunë në familje” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga nenet 130/a dhe 278/2, të Kodit Penal.**

Komisioni konstatoi se procedimi penal referon dhunë fizike në familje të ushtruar nga shtetasi F.J ndaj shtetasit B.J (babait të tij), si dhe kallëzimin e bërë nga ky i fundit në organin e akuzës. Për këtë çështje, gjykata, me vendimin nr. ***, datë 27.7.2012, ka lëshuar urdhër mbrojtje për shtetasin B.J. Në datën 28.8.2012, shtetasi F.J ka ushtruar sërish dhunë ndaj prindërve të tij, B dhe R.J, të cilët kanë bërë përsëri kallëzim penal në datën 29.8.2012. Nga kontrolli në banesë, në dhomën e shtetasit F.J janë gjetur një paketë tritol, 4 pllaka dinamit, si dhe fitil dinamiti.

Nga aktet e administruara u konstatua se Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër, Komisariati i Policisë Mat, me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2012, i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, materialet procedurale në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 22.7.2012, ku në fshatin ***, shtetasi F.J ka ushtruar dhunë fizike ndaj babait të tij shtetasit B.J. Ndërsa, me shkresën nr. *** prot., datë 30.8.2012, Komisariati i Policisë Mat, i ka përcjellë sërish Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, materialet procedurale në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 28.8.2012, ku në mënyrë të përsëritur, shtetasi F.J ka ushtruar dhunë fizike ndaj prindërve të tij dhe i janë gjetur në shtëpi lëndë eksplozive.

Gjithashtu, me shkresën nr. *** prot., datë 10.9.2012, Komisariati i Policisë Mat, i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, materialet procedurale në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 4.9.2012 në fshatin ***, ku shtetasi F.J ka kanosur shtetasen D.J (gruaja e vëllait). Kjo shtetase ka bërë kallëzim penal ndaj tij në datën 5.9.2012, për kanosje, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal.

Me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, datë 3.9.2012, të subjektit të rivlerësimit Leonard Filopati, është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprat penale “dhunë në familje” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga nenet 130/a dhe 278/2, të Kodit Penal, ndaj shtetasit F.J.

Nga ana e policisë gjyqësore janë kryer disa veprime hetimore përpara regjistrimit të procedimit penal, që konsistojnë në marrjen e provës materiale, sekuestrimin e sendeve, si dhe kryerjen e ekspertimit mjekoligjor ndaj të dëmtuarve nga vepra penale.

Në vijim, konstatohet të jenë kryer një sërë veprimesh hetimore si, marrja e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, vleftësimi i kontrollit personal të shtetasit F.J, kryerje ekspertimi tekniko-xhener, pyetja e të arrestuarit, etj.

Subjekti, me kërkesën nr. *** prot. (A.M), datë 11.9.2012, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, ka kërkuar vlerësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg”, ndaj shtetasit F.J.

Me vendimin nr. ***, datë 12.9.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur:

- a) vleftësimin e ligjshëm të ndalimit ndaj shtetasit F.J, nga ana e policisë gjyqësore në datën 10.9.2012; dhe
- b) caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit F.J “arrest me burg”, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale.

Rezulton se ky vendim është ankimuar nga shtetasi F.J, por Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 2.10.2012, ka vendosur miratimin e vendimit penal masë sigurimi nr. ***, datë 12.9.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Në vijim, rezulton se janë kryer disa veprime hetimore në kuadër të marrjes së të dhënave nga personat që kishin dijeni për veprën penale (shtetasit R.J/nëna e të pandehurit, B.J/babi i të pandehurit, A.J /vëllai i të pandehurit, J.J/bashkëshortja e të pandehurit, D.J/kunata e të pandehurit).

Në datën 3.11.2012, OPGJ-ja ka përfunduar hetimin e procedimit penal dhe ka përgatitur relacionin përkatës, ku ka sugjeruar dërgimin e çështjes në gjykatë duke akuzuar të pandehurin F.J, për veprën penale “dhunë në familje” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga nenet 130/a dhe 278/2, të Kodit Penal.

Në datën 21.11.2012, subjekti ka marrë vendimin “për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”. Në dosje evidentohet edhe “procesverbali i njohjes së të pandehurit me aktet, datë 26.11.2012”.

Subjekti, me vendimin e datës 26.11.2012, ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. ***, në ngarkim të të pandehurit F.J:

- për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130a/1, për ngjarjen e datës 21.7.2012, me të dëmtuar B.J;
- për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130a/1, për ngjarjen e datës 28.8.2012, me të dëmtuar B.J.;
- për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130a/1, për ngjarjen e datës 28.8.2012, me të dëmtuar R.J;
- për veprat penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake e municionit”, si dhe veprën penale “pengim për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, të parashikuara nga neni 278/2, si dhe neni 320 të Kodit Penal.

Në konkluzionet përfundimtare për procedimin penal nr. ***, në ngarkim të të pandehurit F.J, subjekti, ndër të tjera, ka kërkuar *pushimin e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit F.J për veprat penale “dhunë në familje” të parashikuar nga neni 130/a dhe veprën penale “pengim për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal, për shkak të amnistisë, bazuar në nenin 5, pika 1, të ligjit nr. 107/2012, datë 8.11.2012,*

“Për dhënie amnistie⁶²”, ku parashikohet se: “Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe nëse ka filluar duhet të pushojë për veprat penale të kryera deri në datën 30 shtator 2012, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë”.

Referuar parashikimit ligjor mbi amnistinë dhe Kodit Penal në fuqi, konfirmohet se veprat penale “dhunë në familje”⁶³ dhe “pengim për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”⁶⁴, të parashikuara nga nenet 130/a dhe 320, të Kodit Penal, përfshihen në kategorinë e veprave penale të amnistuara.

Komisioni, nisur nga fakti se administronte të dhëna vetëm për kallëzime në mënyrë të përsëritur për ushtrim të dhunës në familje, i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me plotësimin e kriterëve të amnistisë për këtë veprë penale, sipas nenit 130/a të Kodit Penal.

Gjithashtu, po për këtë çështje, rezultoi se subjekti në konkluzionet përfundimtare ka kërkuar, deklarimin fajtor të të pandehurit F.J edhe për veprën penale të “mbajtje pa leje të armëve luftarake e municionit”, veprë penale e parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal dhe dënimin me 9 (nëntë) muaj burg.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. ***, datë 16.1.2013, ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit F.J për veprën penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me kohën e paraburgimit prej 6 muaj e 9 ditë burgim.
- Pushimin e gjyqimit të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit F.J për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, si dhe të veprës penale të “pengim për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal, pasi këto vepra penale janë amnistuar, si dhe urdhërimin e lirim të tij të menjëhershëm.

Rezulton që vendimi ka marrë formë të prerë në datën 29.1.2013, duke mos konstatuar kështu problematika lidhur me këtë çështje.

Gjithashtu, Komisionit, nga analiza e akteve⁶⁵ të administruara, i rezultoi se edhe shtetasja D.J kishte kallëzuar shtetasin F.J për veprën penale “kanosje”. Subjekti, megjithëse e ka përmendur çështjen e kanosjes në kuadër të hetimit për familjarët e tjerë për veprën penale “dhunë në familje”, dukej se nuk ishte shprehur lidhur me të, ndërsa në kërkesën që subjekti i drejton Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit është evidentuar kallëzimi i bërë nga shtetasja D.J.

⁶²Neni 7 “Hyrja në fuqi” parashikon: “Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 28 nëntor 2012. Miratuar në datën 8.11.2012. Shpallur me dekretin nr. 7824, datë 19.11.2012, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë”.

⁶³Neni 130/a i Kodit Penal në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012; parashikonte: neni 130/a “Dhuna në familje”: “Rrahja, si dhe çdo veprë tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet. Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet. Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paafësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. Po këto vepra të kryera në mënyrë të përsëritur dënohen me burgim nga një vit gjer në pesë vjet”.

⁶⁴Neni 320 i Kodit Penal në fuqi, parashikonte: “Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi apo shkatërrimi i sendeve për të cilat është marrë një vendim prej gjykatës, ose kryerja e veprimeve të tjera të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

⁶⁵Informacioni për referimin e veprës penale, të datës 7.9.2012, përgatitur nga Oficeri i Policisë Gjyqësore; konkluzionet përfundimtare të subjektit; procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, datë 10.9.2012; kërkesa e subjektit për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit, datë 10.9.2012, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; shkresa nr. *** prot., datë 10.9.2012, e Komisaritit të Policisë Mat, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, për përcjellje të materialeve procedurale në lidhje me ngjarjen e ndodhur më 4.9.2012 në fshatin ***.

Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me këtë konstatim, si dhe të depozitojë çdo dokumentacion provues.

Subjekti i rivlerësimit në qëndrimin e tij, lidhur me *çështjen penale në ngarkim të të pandehurit F.J për veprat penale “dhunë në familje” të parashikuar nga neni 130/a dhe veprën penale “pengim për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal, pushuar për shkak të amnistisë*, ndër të tjera, ka parashtruar se referuar jurisprudencës së konsoliduar të gjykatave, që vepra penale të kualifikohet në neni 130/a paragrafi 4, në rastin konkret, pra, që të konsiderohej përsëritës duhet që ndaj autorit të veprës të ekzistojë një vendim dënimi i mëparshëm i formës së prerë, po për këtë vepër penale (neni 130/a). Subjekti është shprehur se për sa i përket veprës penale “pengim për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal, qëndron si fakt penal më vete, por ajo konsiderohet e konsumuar në momentin kur autori shkel një nga pikat e dispozitivit të urdhrit të mbrojtjes së gjykatës.

Ndërsa, lidhur me veprën penale të kanosjes, subjekti ka sqaruar se në rastin konkret elementet e veprës penale “kanosje” nuk janë konsideruar se qëndronin si të tilla më vete, por përthithen nga vepra penale “dhunë në familje”, për të cilën ai është akuzuar tre herë për secilin episod dhe subjekt të dëmtuar më vete.

Trupi gjykues, në analizë të rrethanave të konstatuara, në raport me ligjin e aplikuar sa i përket përfitimt të amnistisë, lidhur me akuzën për ushtrim të dhunës në familje, vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse, pasi në rastin konkret nuk rezultoi ndonjë vendim dënimi i formës së prerë, sikurse e kërkon neni 130/a i Kodit Penal. Ky konkluzion gjendet në harmoni edhe me nenin 50 të Kodit Penal, i cili parashikon rrethanat rënduese të kryerjes së një vepre penale, ku citohet shprehimisht: *“Rëndojnë dënimin rrethanat që vijojnë... ç) kryerja e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë”*...; nenin 462 të Kodit Procedurës Penale, ku parashikohet: *“1. Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim pasi të ketë marrë formë të prerë...”*, si dhe i lidhur ngushtësisht me parimin e prezumimit të pafajësisë, sipas nenit 30 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Po ashtu, trupi gjykues vërejt se qëndrimi i subjektit është kontrolluar edhe nga gjykata dhe për pasojë nuk evidentoi ndonjë problematikë.

Gjithashtu, trupi gjykues i çmon bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me përfshirjen e hetimit për akuzën e kanosjes në akuzën e dhunës në familje, sikurse e parashikon nenin 130/a, paragrafi 2, dhe për rrjedhojë nuk konkludon në ndonjë problematikë që mund të ndikojë në rivlerësimin e kriterit profesional.

c) Komisioni administroi fashikullin penal që i përket procedimit penal nr.***, regjistruar në datën 21.4.2013, në ngarkim të të pandehurit A.K, akuzuar për veprën penale të “vjedhje me dhunë”, parashikuar nga neni 139 të Kodit Penal.

Komisioni konstatoi se çështja i referohet vjedhjes me dhunë të një sasive prej 62.000 lekësh nga shtetasi A.K, i cili është arrestuar në flagrancë, duke pranuar kryerjen e veprës penale, të cilit, gjithashtu, i është sekuestruar shuma prej 44.000 lekë.

Komisioni konstatoi se pas referimit të veprës penale, nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër, Komisariati i Policisë Mat, nga ana e policisë gjyqësore, janë kryer disa veprime⁶⁶ hetimore, përpara regjistrimit të procedimit penal.

⁶⁶(i) Plotësimin e raportit mbi raportimin e ngjarjes; (ii) arrestimin në flagrancë të shtetasit A.K dhe kontrollin personal të tij; (iii) këqyrjen e vendit të ngjarjes, si dhe sekuestrimin e provave materiale kartëmonedha gjithsej 44 copë të prerjes 1.000 lekë; (iv) marrjen e deklaratimit nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, shtetasi A.K; (v) marrjen e të dhënave nga personat që ka dijeni për veprën penale, shtetasit V.K (babai i të pandehurit), H.K (xhaxhai i të pandehurit), H.K (dëshmitar), si dhe nga i dëmtuari; (vi) lënien në ruajtje të provave materiale, datë 21.4.2013, për të cilat janë mbajtur procesverbalet përkatëse.

Me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, datë 21.4.2013, të subjektit të rivlerësimit Leonard Filopati, është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprën penale “*vjedhje me dhunë*”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal, ndaj shtetasit A.K, për të cilin rezultoi se janë kryer disa veprime hetimore të tjera si: (i) pyetja e të arrestuarit A.K; (ii) marrja e dy vendimeve nga subjekti për vleftësimin e sekuestros për kartëmonedhat dhe të dy qeseve të disponuara nga i dyshuari në momentin e arrestimit; (iii) marrja e urdhrin për lënien në ruajtje të provave materiale; (iv) kërkesë e subjektit për vlerësim arresti në flagrancë dhe caktim të masës së sigurisë “arrest me burg” ndaj të dyshuarit, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Me vendimin nr. ***, datë 24.4.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat.
- Vlerësimin të ligjshëm të arrestit në flagrancë, të marrë ndaj shtetasit A.K, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*vjedhje me dhunë*”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal.
- Caktimin e masës së sigurimit personal për shtetasin A.K “arrest me burg”, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe njoftimin e të drejtës për ankim.

Subjekti ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore (datë 24.04.2013), duke kërkuar pyetjen e të dëmtuarit I.D mbi ngjarjen, nëse ka pasur dëmtime dhe, nëse po, të kryhet ekspertim mjekoligjor, administrimin e certifikatës së gjendjes gjyqësore të A.K, si dhe kryerjen e çdo lloj veprimi të nevojshëm.

Në vijim, janë kryer veprime të tjera hetimore si, fotografimi i vendit të ngjarjes nga eksperti kriminalist, ekzekutimi i urdhrin të prokurorit për kthimin e sendeve të sekuestruara (për kartëmonedhat), marrja e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, shtetasi I.D (i dëmtuari).

Subjekti i rivlerësimit me vendimin e datës 11.6.2013, e ka marrë shtetasin A.K në cilësinë e të pandehurit dhe e ka njoftuar me akuzën për veprën penale “*vjedhje me dhunë*”, të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal.

Subjekti ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore (datë 12.6.2013), lidhur me njohjen e të pandehurit me akuzën dhe aktet.

Në vijim, është pyetur dy herë i pandehuri (më 4.7.2013 dhe 9.7.2013) dhe janë mbajtur procesverbalet përkatëse.

Me vendimin e datës 15.7.2013, subjekti, pasi ka vlerësuar se janë kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme, janë mbledhur të gjitha provat që vërtetojnë fajësinë e të pandehurit dhe ky i fundit është njohur me aktet procedurale të procedimit penal, ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. ***, në ngarkim të të pandehurit për veprën penale “*vjedhje me dhunë*”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal.

Komisionit i rezultoi se subjekti, në konkluzionet përfundimtare të datën 17.2.2014, ka kërkuar *deklarimin fajtor të të pandehurit A.K për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal dhe dënimin me 18 (tetëmbëdhjetë) muaj burg*. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat ka dënuar të akuzuarin për veprën penale të vjedhjes me 1 (një) vit e 6 muaj burgim, i ankimuar më pas nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Mat.

Çështja rezultoi të ishte në Gjykatën e Lartë mbi rekursin e ushtruar nga organi i akuzës për prishjen e vendimit penal nr. ***, datë 19.11.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe deklarimin fajtor të të pandehurit A.K për veprën penale “*vjedhje me dhunë*” të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim.

Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime mbi ndryshimin e akuzës ndaj të pandehurit A.K nga “vjedhje me dhunë”⁶⁷, të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal, në veprën penale “vjedhja”⁶⁸, të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal, si pasojë e së cilës është kërkuar edhe ndryshimi i masës së dënimit nga 5 (pesë) vite burgim në 18 (tetëmbëdhjetë) muaj burgim, si dhe depozitohet çdo dokumentacion i justifikues.

Gjithashtu, Komisioni nisur nga fakti se i dëmtuari I.D kishte ndryshuar dëshminë dhe, për rrjedhojë, ishte vendosur regjistrimi i procedimit penal në ngarkim të tij, për veprën penale të “deklarimit të rremë përpara Oficerit të Policisë Gjyqësore”, i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me ecurinë e këtij procedimi penal të regjistruar, si dhe depozitim të çdo dokumentacioni i justifikues.

Subjekti mbi konstatimet e Komisionit fillimisht ka qartësuar se kjo çështje ka përfunduar me Mospranim rekursi në Gjykatën e Lartë, konkretisht me vendimin nr. ***, datë 31.03.2016, dhe se, në të gjithë shkallët e gjyqësorit është mbështetur qëndrimi i tij.

Subjekti ka shpjeguar bazuar në doktrinën penale dhe parimet bazë të legjislacionit penal, ku nuk ka dhe nuk mund të ketë dënim pa prova, dhe se konkretisht ndarja e cilësimit të veprës penale nga “vjedhje me dhunë” dhe “vjedhje”, ndryshon vetëm nga veprimet agresive të autorit të të pandehurit A.K, në këtë rast. Në vijim, subjekti ka sqaruar se fillimisht i dëmtuari ka pretenduar se gjatë vjedhjes është përdorur dhunë për t’i marrë paratë e tij të pensionit, por duke qenë se çështja është shqyrtuar me procedurën e gjyqësorit të zakonshëm, gjatë shqyrtimit gjyqësor janë marrë sërish provat përpara gjykatës.

Subjekti ka parashtruar se i dëmtuari në gjykim ka cituar disa herë që vjedhja nuk ishte bërë me dhunë nga i pandehuri, duke ndryshuar kështu deklaratimet e dhëna gjatë hetimeve paraprake para policisë gjyqësore.

Subjekti ka qartësuar se prej tij ishte kryer veprimi procedural i kundërshtimit të dëshmisë, parashikuar nga neni 362 i Kodit të Procedurës Penale, duke paralajmëruar për përgjegjësinë penale që i dëmtuari kishte për shkak të ndryshimit të dëshmisë dhe për faktin se ky i fundit kishte ridekluar për vjedhje jo me dhunë, i kishte regjistruar të dëmtuarit procedim penal ndaj tij për dëshmi të rremë.

Subjekti ka sqaruar se këto kanë qenë arsyet të cilat kanë çuar atë në ndryshim të akuzës dhe për pasojë edhe të dënimit të kërkuar.

Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë procesit, si dhe nga shpjegimet e dhëna nga subjekti, konstatoi se subjekti kishte ndërmarrë veprimin procedural për regjistrimin e procedimit penal në ngarkim të të dëmtuarit për shkak të ndryshimit të dëshmisë së tij në gjykim, krahasimisht me dëshminë e dhënë në policinë gjyqësore, kishte dërguar kërkesën për gjykim në gjykatë dhe njëkohësisht kishte kërkuar edhe dënimin e tij, ndërsa çështja rezultoi e amnistuar për shkak të ligjit të kohës. Në të tilla kushte, qëndrimi i subjektit në gjykim lidhur me ndryshimin e akuzës dhe, për pasojë, edhe me ndryshimin e masës së dënimit ka ardhur si pasojë e ndryshimit të qëndrimit të të dëmtuarit për të cilin nga aktet rezultoi se subjekti ka ndërmarrë veprimet procedurale “kërkesë për gjykim” ndaj tij, akuzuar për deklarim të rremë. Po ashtu, konstatohet se vendimmarrjet e gjykatave kanë mbështetur dhe ligjëruar qëndrimin e subjektit. Nën këto argumente nuk konstatohen problematika lidhur me rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

⁶⁷Neni 139, “vjedhja me dhunë”, parashikon: “Vjedhja e pasurisë e shoqëruar me përdorim dhune dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet”.

⁶⁸Neni 134, vjedhja, (shtuar një paragraf me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004; ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012), parashikon: “Vjedhja e pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. E njëjta vepër, kur ka sjellë pasojë të rënda dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet”.

ç) Komisioni administroi fashikullin penal që i përket procedimit penal nr.***, regjistruar në datën 14.6.2013, në ngarkim të shtetasve A.S (Kryetar i Komunës ***) për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, D.F për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “falsifikimi i dokumenteve” parashikuar nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal, L.A për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, D.P për veprën penale të “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, Q.M për veprën penale të “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, I.B për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, si dhe H.B, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Nga të dhënat e administruara çështja i referohet pretendimeve për keqpërdorim të fondeve të buxhetit të shtetit në procedurat e prokurimit.

Komisionit, nga aktet e administruara, i rezultoi se përgjithësisht ish-in kryer veprimet hetimore nga subjekti, i cili e ka vijuar këtë çështje pas hetimit të saj nga disa subjekte⁶⁹ të tjerë.

Subjekti, pas regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, datë 19.12.2014 dhe kryerjes së disa veprimeve procedurale⁷⁰, datë 22.12.2014, ka dalë me vendimet përkatëse për marrjen e këtyre shtetasve si të pandehur dhe njoftimin e akuzës dhe, më tej, në datën 28.1.2015, ka bërë kërkesën për gjykimin e çështjes drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Pas këtij momenti, subjekti është zëvendësuar nga një tjetër subjekt rivlerësimi për vijimin e çështjes për shkak të dorëheqjes së tij dhe kalimit në një detyrë tjetër në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë.

Nga verifikimi i akteve të dosjes lidhur me afatet e hetimeve paraprake, rezultoi se regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale është bërë nga subjekti në datën 19.12.2014, ndërkohë që çështja është dërguar për gjykim në datën 28.1.2015, brenda afatit 3-mujor, sikurse përcaktohet në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale (ligji në fuqi në momentin e kryerjes së veprës penale). Në të tilla kushte nuk u diktua ndonjë problematikë lidhur me rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

d) Komisioni administroi fashikullin penal që i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 3.7.2012, në ngarkim të të pandehurve M.C, i akuzuar për veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 të Kodit Penal, B.M, i akuzuar për veprat penale “vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal dhe “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, E.I i akuzuar për veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal dhe D.F, i akuzuar për veprën penale “falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

Nga analizimi i fashikullit penal, Komisionit i rezultoi se hetimi i këtij procedimi penal është kryer nga një subjekt tjetër, z. S.K (prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat).

⁶⁹Me vendimin e datës 17.10.2013, të Drejtuesit të Prokurorisë, z. A.M, është zëvendësuar prokurori S.K⁶⁹ me prokurorin Leonard Filopati (subjekti i rivlerësimit).

⁷⁰Kërkimi i dokumentacionit ligjor të disa subjekteve tregtare, pyetjen e Zyrës së Punës nëse këto subjekte kanë patur punonjës, sekuestrimi i praktikave të tenderëve, pyetja e anëtarëve të komisioneve të tenderëve, këqyrje në lidhje me tenderët nëse janë realizuar, pyetjen e disa personave. Pyetja e personave në hetim, Pyetja e të pandehurve, Njohja e të pandehurve me aktet procedurale, në bazë të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale. Administrimi i raporteve të auditimit ekonomiko-financiar të Komunës ***, nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm pranë Ministrisë së Brendshme; Sekuestrimi i praktikave të tenderëve për vitin 2010 - 2011 në Komunën ***, datë 17.2.2014; kërkesë për dosjen e automjetit tip “****”, me targa ***, sekuestrim i dokumenteve (procesverbalet e marrjes në dorëzim të mallrave dhe shpërndarjes së tyre nga magazinieri për tenderët e blerjeve të vogla për vitet 2010 - 2011, procesverbalet e inventarëve për vitet 2008 - 2012); marrja e të dhënave nga personat që kanë dijeni për veprën penale; vendim për kryerjen e ekspertimit (teknik-grafik-shkrimi-nënshkrimi, si dhe krahasim vulash), datë 21.5.2014.

Prokurori z. S.K, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal (kryesisht), nr. ***, datë 3.7.2012, për veprat penale të “shpërdorimit të detyrës” dhe “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal.

- Nga verifikimi i akteve rezultoi se subjekti nuk ka pasur rol në këtë çështje.

dh) Komisioni administroi fashikullin penal që i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 22.1.2015, në ngarkim të të pandehurit H.K, akuzuar për veprat penale “vjedhje të energjisë elektrike”, “dhunë në familje” dhe “mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 137/1, 130/a/1, 278/2, 278/3 dhe 278/4, të Kodit Penal. Nga aktet e administruara, rezultoi si vijon:

Komisionit i rezultoi se çështja i referohet kallëzimit të bërë nga shtetasja I.K, në janar të vitit 2015, e cila pretendonte se ishte kërcënuar nga bashkëjetuesi H.K, gjatë kohës që qëndronte në shtëpinë e tij në fshatin ***, Komuna ***, Mat. Mbi këtë kallëzim policia gjyqësore ka kontaktuar me shtetasen I.K dhe pas kontrollit të ushtruar në banesë janë gjetur dhe sekuestruar brenda dhe jashtë banesës tre armë zjarri, municione të ndryshme dhe lëndë plasëse, etj. Po ashtu, është konstatuar edhe lidhje e paligjshme në rrjetin e energjisë elektrike. Për veprimet e konstatuara gjatë këqyrjes janë mbajtur procesverbalet përkatëse dhe janë administruar në dosjen hetimore tabelat përkatëse fotografike. Policia ka bërë arrestimin në flagrancë të këtij shtetasi.

Nga aktet e administruara rezultoi se Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër, Komisariati i Policisë Mat, me shkresën nr. *** prot, datë 22.1.2015, i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, materialet procedurale për veprën penale “dhunë në familje”, “mbajtje pa leje e armëve luftarake, municionit luftarak dhe lëndëve plasëse” dhe “vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga nenet 278/2/3/4, 130/a dhe 137/1, të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit H.K.

Me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, datë 22.1.2015, të subjektit të rivlerësimit Leonard Filopati, është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprën penale “prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake, municionit luftarak dhe lëndëve plasëse”, “dhunë në familje” dhe “vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga nenet 278/2/3/4, 130/a dhe 137/1, të Kodit Penal, ndaj shtetasit H.K.

Subjekti ka dalë me disa vendime për vlerësimin e sekuestros (armë zjarri, municion, fishekë dhe granata), për vlerësimin e kontrollit (në ambientet e brendshme dhe të jashtme), si dhe janë marrë në pyetje i arrestuari H.K, kallëzuesja, babai i të arrestuarit, etj.

Në vijim, subjekti, me urdhrin e datës 27.1.2015, ka kërkuar kryerjen e veprimeve hetimore deri në datën 20.2.2015.

Subjekti i rivlerësimit, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat me “kërkesë për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit”, nr. *** prot., datë 23.1.2015, ku ka kërkuar që ndaj të pandehurit të merrej masa e sigurimit “arrest me burg”, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale.

Në vijim të kësaj kërkesë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, ka dalë me vendimin nr. ***, datë 23.1.2015, nëpërmjet të cilës ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat për vlerësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit H.K dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest me burg”, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale.

Me vendimin nr. ***, datë 12.2.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. ***, datë 23.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Subjekti i rivlerësimit ka vendosur⁷¹ marrjen e shtetasit H.K si të pandehur dhe i ka njoftuar akuzën për veprën penale “prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municioneve”, “dhunë në familje” dhe “vjedhje e energjisë elektrike”, të parashikuar nga nenet 278/2, 130/a dhe 137/1, të Kodit Penal. Referuar këtij vendimi, ku janë evidentuar veprimet hetimore të kryera në kuadër të provueshmërisë së akuzave të ngritura, ndër të tjera, subjekti citon se *ka dyshime të arsyeshme plotësisht të bazuara se subjekti i veprave penale “prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municioneve” është shtetasi S.K (babai i të pandehurit)*. Në vijim referon procesverbalin e marrjes së të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, datë 16.2.2015, të shtetasit S.K, ku ky i fundit ka pranuar që pushkët, automatikët, fishekët granatën dhe dinamitin që janë gjetur në banesën e tij i kishte gjetur ai që nga viti 1997. Në këtë kuadër, referuar vendimit citohet se: *“Në këto rrethana është vendosur regjistrimi i emrit të shtetasit S.K, duhet të shënohet në kolonën përkatëse të regjistrit të njoftimit të veprave penale, për procedimin penal nr. ***, për veprën penale ‘prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municioneve’ të parashikuar si veprë penale në nenet 278/2/3/4, të Kodit Penal”*.

Në vijim të këtij vendimi, i pandehuri H.K ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga “arrest me burg” në “detyrim për tu paraqitur” (kërkesë e dakordësuar edhe nga subjekti, pasi sipas tij nevojat e sigurisë dhe se kushtet e masës së sigurimit kanë ndryshuar dhe se kërkesa e të arrestuarit duhet pranuar) dhe me vendimin nr. ***, datë 20.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, është vendosur⁷² pranimi i kësaj kërkesë, vendim ky i mbetur në fuqi⁷³. Megjithëse nga subjekti është konkluduar me urdhrin për ekzekutimin e vendimit, në datën 23.2.2015, Prokurori i Rrethit Mat ka bërë “ankim, kundër vendimit penal nr. ***, datë 20.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat”.

Komisioni, në këtë çështje nga analizimi i fashikullit të procedimit penal, ka konstatuar se Prokuroria e Përgjithshme (Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore), me shkresën nr. *** prot., datë 4.6.2015, ka hetuar dhe analizuar veprimet e subjektit të rivlerësimit dhe oficerit të policisë gjyqësore, aktet procedurale në dosjen penale dhe ka konkluduar disa mangësi.

Sa më sipër, Prokuroria e Përgjithshme, duke çmuar se nuk legjitimohen për ushtrimin e mëtejshëm të funksionit të ndjekjes penale në këtë procedim penal, referuar nenit 27/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar zëvendësimin e tyre në këtë procedim penal.

Në vijim rezulton se, drejtuesi i Prokurorisë Mat, z. A.M, me urdhrin datë 5.6.2015, “Për zëvendësimin e prokurorit dhe OPGJ-së në hetimin e procedimit penal nr. ***”, ka urdhëruar që vijimi i procedimit penal t’i kalojë një subjekti tjetër rivlerësimi.

Komisioni konstaton se, referuar Urdhrit të Drejtuesit të Prokurorisë Mat, lidhur me arsyet e zëvendësimit të subjektit, paraqiten të njëjtat argumente që referohen në konstatimet e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore të Prokurorisë së Përgjithshme.

Me shkresën nr. *** prot. (A/P), datë 8.6.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, i ka dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” në atë të “arrestit me burg”. Në vijim të proceseve gjyqësore referuar diskutimit përfundimtar (nga subjekti zëvendësues) në datën 16.2.2016, ndër të tjera, rezulton se: *“I pandehuri është me masë sigurimi arrest në burg në mungesë”*. Ndërsa, lidhur me themelin e çështjes, sipas dokumentacionit të administruar, është vendosur nga Gjykata e Apelit, që i pandehuri të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës. Më tej, çështja rezulton të jetë rekursuar nga Prokuroria pranë

⁷¹Me vendimin datë 17.2.2015, “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”.

⁷²Referohuni vendimit pas f. *** në fashikull.

⁷³Me vendimin nr. ***, datë 23.3.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Gjykatës së Apelit Tiranë, në datën 12.4.2018, duke kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim.

Në konkluzion, Komisionit, nga analizimi i fashikullit penal, i rezultoi se qëndrimi i subjektit, lidhur me akuzën ndaj shtetasit H.K, kishte ndryshuar në vendimin e datës 17.2.2015, “për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, ku dukej se kishte rënë akuza “prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municioneve” të Kodit Penal.

Ky qëndrim dukej i bazuar në ndryshimin e deklaramit të babait të të pandehurit, i cili fillimisht⁷⁴, gjatë veprimeve të para hetimore, në datën 21.1.2015, kishte deklaruar se nuk kishte dijeni për armët, municionet dhe lëndët plasëse, për arsye se ishte i vjetër dhe i sëmurë, dhe, më pas, me vijimin e hetimeve në datën 16.2.2015⁷⁵, kishte deklaruar se këto armë, municione luftarake dhe lëndë plasëse i përkisnin atij dhe ishin mbajtur nga ana e tij që në vitin 1997. Dukej se në këtë hetim nuk ishin marrë në konsideratë deklaramet e shtetasit I.K se armët dhe municionet ishin sjellë nga bashkëjetuesi i saj, i pandehuri H.K, dhe se nuk ishin kryer veprime të tjera hetimore siç mund të ishte ballafaqimi i të dëmtuarës I.K me personat e dyshuar si autorë të veprës penale S.K e H.K, sipas nenit 169 të Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim të trajtimit të kësaj çështje, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime për sa konstatohej, si dhe të depozitonte dokumentacionin mbështetës.

Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit të qartësonte statusin e kësaj çështje, për të cilën rezultoi se ajo ishte rekursuar.

Subjekti i rivlerësimit në qëndrimin e tij, ndër të tjera, ka sqaruar se në asnjë rast nuk ka favorizuar askënd, ka mbajtur qëndrim ligjor dhe në përputhje me provat. Subjekti ka pretenduar se qëndrimi i tij ka qenë i drejtë, i mbështetur në ligj dhe në prova.

Subjekti ka vënë në dukje se në vlerësimin e tij kanë qenë dy elementë kryesorë mbi të cilat ka krijuar bindjen se shtetasi H.K nuk mund të ishte personi që kishte blerë sendet e paligjshme, si armë fishekë dhe lëndë plasëse, duke e lidhur këtë me faktin se nga tabelat fotografike të administruara pjesa më e madhe e tyre kanë qenë tejet të ndryshkura. Subjekti ka depozituar disa foto.

Subjekti ka qartësuar se i pandehuri në atë kohë kishte parashikuar të largohej nga Shqipëria, së bashku me fëmijët e mitur (pas dy ditësh me avion), ndaj nuk ishte logjike që ai të blinte këto armë, të cilat nuk mund t’i merrte me vete.

Subjekti i është referuar edhe dëshmisë së babait të të pandehurit se armët ishin pas vitit 1997, duke i krahasuar këtë dëshmi me fotot. Nën këto detaje, subjekti vë theksin te përforcimi i bindjes së tij se këto armë nuk ishin blerë nga i pandehuri.

Në lidhje me ndryshimin e masës së sigurimit, subjekti ka renditur edhe faktorë të tjerë të marrë në konsideratë prej tij, si: (i) fakti se i pandehuri kishte ardhur me dy fëmijë të mitur rreth 3-4 vjeç, të cilët dinin vetëm anglisht, pra, nuk komunikonin shqip lidhur me nevojat e tyre të përditshme; (ii) gjyshi i tyre, tashmë i vetëm, nuk arrinte t’i kuptonte apo edhe të sqaronte për çdo nevojë jetësore; (iii) mungesa e nënës së tyre që ishte në Angli me dy fëmijët e tjerë të mitur dhe nuk arrinte të vinte në Shqipëri t’i merrte; si dhe (iv) veçanërisht interesi më i lartë i fëmijës.

Subjekti ka sqaruar se nuk ka bërë asnjë favorizim për sa kohë ka akuzuar babain e të pandehurit, si edhe të birin për dy veprat e tjera, duke u përpjekur të ndaj përgjegjësinë penale në mënyrë të drejtë dhe të bazuar në prova, pa favorizuar askënd.

⁷⁴Referuar procesverbalit, datë 21.1.2015, f. *** në fashikull.

⁷⁵Referuar procesverbalit, datë 16.2.2015, f. *** në fashikull.

Subjekti ka konfirmuar se në vendimmarrjet e gjykatës, lidhur me masën e sigurisë në të gjitha shkallët e gjykimit, është mbështetur qëndrimi i tij, që sipas tij nëse do të kishte qenë i gabuar nuk kishte arsye përse gjykatat më të larta të mbështesnin qëndrimin e tij, edhe pse drejtuesi i prokurorisë pretendonte se ky qëndrim nuk ishte i drejtë dhe për këtë kishte bërë një sërë hamendësimesh dashakeqe kundra tij.

Subjekti ka parashtruar se rrezikshmëria shoqërore e të pandehurit është vlerësuar si e vogël edhe nga gjykata që ka shqyrtuar themelin e çështjes, duke aplikuar një nga alternativat e dënimit me burgim për të.

Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe rrethanave të rezultuara lidhur me këtë çështje, por edhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nuk konstatoi shkelje procedurale në asnjërin prej rasteve të vendosjes së masës së sigurimit personal dhe zëvendësimit të saj, për më tepër, kur identifikohen faktorë të cilët kanë qartësuar pozitën e të pandehurit në raport me çështjen penale në tërësi dhe, për pasojë, kanë mundësuar zëvendësimin e masës së sigurimit. Nga ana tjetër, vërehet, gjithashtu, se gjetjet e inspektimit janë adresuar pas kontrollit të vendimmarrjeve nga gjykatat të cilat në të dy rastet e vendosjes së masës së sigurimit personal, por edhe të asaj të zëvendësimit, me gjithë qëndrimin ndryshe të drejtuesit të organit të akuzës, pra duke përkrahur qëndrimin e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, edhe detyrat e lëna nga gjetjet e konstatuara në raportin e inspektimit nuk kanë rezultuar të suksesshme as edhe nga veprimet hetimore të mëtejshme të kryera nga subjekti zëvendësues që ka vijuar me hetimin e çështjes. Më konkretisht, lidhur me ballafaqimin e lënë detyrë për t'u kryer mes kallëzueses dhe personave të dyshuar ka rezultuar se, me gjithë kërkimet e bëra, kallëzuesja ishte larguar jashtë vendit. Një argument tjetër në favor të subjektit është, gjithashtu fakti që edhe vendimmarrja e themelit ka rezultuar në dhënien e dënimit alternativ ndaj këtij të pandehuri. Në përfundim, trupi gjykues për sa kohë: (i) nuk konstatoi shkelje të karakterit procedural në hetimin e kësaj çështje; (ii) për faktin se nuk ka kompetencë të trajtojë themelin e saj, a as të cenojë korrektësinë e vendimit e të zëvendësojë logjikën e subjektit, megjithëse në këtë rast rezultoi se dy prej akuzave nuk i takonin të pandehurit; (iii) për sa rezultoi se vendimmarrjet e gjykatës kanë mbështetur qëndrimin e subjektit të rivlerësimit; (iv) çështja administrative e dhënies së masës disiplinore vijon të jetë në proces gjyqësor, çmon se nuk identifikohen elementë, të cilët ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, të mund të cenojnë figurën e tij.

ç) Komisioni administroi fashikullin penal që i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 21.4.2015, për veprën penale “shpërdorim detyrë”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Komisionit, sipas të dhënave të administruara, i rezultoi se procedimi penal identifikon dy kallëzime të bëra në mars të vitit 2015 ndaj këshilltarëve të Komunës ***, lidhur me vendimin e tyre për burimin e ujit dhe pretendimet e tyre, lidhur me shpërndarjen, duke hedhur dyshime për shpërdorim të fondeve dhe devijim të projektit të investuar nga komuna.

Gjithashtu, nga aktet e administruara, u konstatua se nga OPGJ-ja⁷⁶ është sugjeruar mosfillimi i procedimit penal për kallëzimin e regjistruar, bazuar në nenin 290/1 të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk rezulton ndonjë bazë për të regjistruar procedimin penal.

Me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, datë 21.4.2015 (në urdhër nuk parashikohet emri i personit ndaj të cilit ka filluar procedimi penal), të subjektit të rivlerësimit Leonard Filopati, është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

⁷⁶Referuar “Relacionit për përfundimin e verifikimit të kallëzimit penal nr. *** të vitit 2015”, datë 20.4.2015.

Subjekti, me urdhrin “Për kryerjen e veprimeve hetimore”, datë 23.4.2015, ka kërkuar kryerjen e disa veprimeve hetimore të tilla si, këqyrja e objektit të Ujësjellësit, fotografimi, caktimi i ekspertit për të bërë vlerësimin, pyetja e banorëve, kryetarit të Komunës, përfaqësuesit të firmës fituese dhe kolaudatori i punimeve, deri në datën 23.5.2021.

Nga fashikulli penal rezulton se në kuadër të hetimit janë kryer një sërë veprimesh⁷⁷ hetimore.

Referuar relacionit për përfundimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***, datë 24.12.2015, të përgatitur nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, z. I.H, ku parashikohen pretendimet e kallëzuesit, fakte të rezultuar mbi investimin e kryer nga Komuna ***, veprimet hetimore të kryera, lidhur me pyetjen e personave që kanë dijeni dhe ekspertimin teknik për ndërtimin e kryer, në përfundim rezulton se OPGJ-ja është shprehur se nuk janë konsumuar elementet e veprës penale dhe bazuar në gërmën “a”, të pikës 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale ka sugjeruar që procedimi penal të pushohet.

Rezulton se, me vendimin e datës 29.12.2015, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***. Subjekti në këtë vendim paraqet pretendimet e kallëzuesit, veprimet hetimore që janë kryer, dokumentacionin e administruar në kuadër të hetimit, duke e vendosur theksin në rezultatet e ekspertimit teknik të kryer, nga ku është konkluduar: *“1.Punimet ndërtimore janë kryer komfor projekteve teknike dhe preventivit të punimeve shoqëruar me ndryshimet respektive të përshkruara në dokumentet e përgatitura nga ana e Autoritetit kontraktor për këtë qëllim. 2. Nuk ka shmangie apo devijim të projektit (përpos ndryshimeve të miratuara) nga pikëpamja thelbësore e funksionimit me ujë. 3. Objekti siguron qëndrueshmëri nga pikëpamja teknike e funksionimit të tij”*.

Në përfundim, subjekti arsyeton se në referim të fakteve dhe provave të administruara, rezulton se nuk ka të dhëna për ekzistencën e elementeve të veprës penale “shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Në vijim me shkresën nr. *** prot. (L.F), datë 30.12.2015, janë njoftuar subjektet e hetimit mbi mënyrën e përfundimit të procedimit penal. Për këtë çështje, subjekti është shprehur se nuk ka pasur ankim.

Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara mbi hetimin e kryer për këtë procedim penal, nuk vërejtë shkelje të karakterit procedural nga subjekti dhe as problematika që të ndikojnë në rivlerësimin e tij profesional.

d) Komisioni administroi fashikullin penal që i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 21.10.2015, në ngarkim të të pandehurit M.LL, akuzuar për veprat penale “kanosje”, “prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit” dhe “prishje e rendit dhe qetësisë publike”, parashikuar nga nenet 84, 278/2 dhe 274, të Kodit Penal.

Komisionit, sipas të dhënave të administruara, i rezultoi se procedimi penal i referohet të shtënave me armë zjarri në datën 16.10.2015, rreth orës 22:50, në qytetin e Burrelit, në aksin rrugor qendër ***, në afërsi të lokalit “****”, në pronësi të shtetasit XH.M, ku policia gjyqësore

⁷⁷Kryerje e ekspertimit tekniko-ekonomik të zbatimit të punimeve për objektin “Ndërtim Ujësjellësi ***, komuna ***”, nga eksperti Z.M (licencuar në fushën e projektimit dhe zbatimit të punimeve në ndërtim), i cili ka konkluduar se: *“Punimet janë zbatuar në përputhje me volumet e përfshira në situacionet e punimeve dhe se ndryshimet e projektit janë reflektuar sipas rekomandimeve të projektuesit”*. Këqyrje e objektit ujësjellësit të ujit të pijshëm ****, nga eksperti, në praninë e prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqësore. Janë thirrur shtetasit F.D dhe H.D në datën 29.4.2015. Kryerje e fotove të ndryshme të investimit të kryer për ujësjellësin. Janë administruar nga OPGJ-ja prova materiale të dorëzuara nga kallëzuesi, nga shtetasi S.GJ (Kryetari i Komunës ***), nga shtetasi K.C (mbikëqyrës punimesh). Janë marrë të dhëna nga disa persona që kishin dijeni për veprën penale, S.GJ (Kryetar i Komunës ***), A.GJ (kallëzuesi), M.P, (përfaqësues i firmës ndërtuese), H.D (ish-këshilltar Komune ***), F.D (Kryetar i fshatit ***), shtetasit R.K, N.M, F.M, H.B, B.GJ, F.M dhe K.C.

ka cituar se nga informacione konfidenciale, person i dyshuar ishte shtetasi M.LL, lindur dhe banues në fshatin ***, të rrethit Mat.

Nga dokumentet e fashikullit penal rezulton që prokuror i kësaj çështjeje është subjekti i rivlerësimit deri në datën 11.3.2016, ku me vendim të drejtuesit të prokurorisë është caktuar një subjekt tjetër për vijimin e hetimit, pasi subjekti i rivlerësimit ka kaluar në një pozicion tjetër në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë.

Nga aktet e administruara u konstatua se Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër, Komisariati i Policisë Mat, me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2015, i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, materialet procedurale për veprat penale “mbajtje e armëve luftarake në mjedise publike” dhe “prishje e rendit dhe qetësisë publike”, parashikuar nga nenet 278/4 dhe 274 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit M.LL.

Rezulton se, po në këtë datë, subjekti ka marrë vendim për lejimin e përgjimit, për disa persona (të dyshuarin, të afërm të tij dhe një person tjetër të përfshirë në konflikt). Në të njëjtën kohë ka bërë kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat “për vleftësimin e vendimit të prokurorit për lejimin e përgjimeve telefonike si dhe lejimin e përgjimeve”.

Me urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, datë 21.10.2015, të subjektit të rivlerësimit Leonard Filopati, është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprat penale “prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit” dhe “prishja e rendit dhe qetësisë publike”, parashikuar nga nenet 278/5 dhe 274, të Kodit Penal, ndaj shtetasit M.LL.

Rezulton se subjekti, përpara regjistrimit të procedimit penal ka kryer disa veprime procedurale, duke ndërmarrë disa vendime dhe urdhra⁷⁸ për kryerjen e veprimeve hetimore (lejimin e përgjimeve për të dyshuarin, vëllain, nënën dhe personin e përfshirë në konflikt).

Rezulton se, subjekti, me vendimin e datës 21.1.2016, ka zgjatur afatin hetimor⁷⁹ për procedimin penal nr. ***, deri në datën 21.4.2016. Nga studimi i akteve, subjekti ka konkluduar se duhet të kryhen dhe disa veprime procedurale në një kohë sa më të shpejtë (duke cituar veprimet).

Sipas pikës 2 të këtij vendimi është parashikuar njoftimi i të interesuarit/ve vendimi, të cilët brenda 10 ditëve nga marrja dijeni kanë të drejtën e ankimit në gjykatë. Në fund të këtij vendimi rezulton se personi nën hetim M.LL ka nënshkruar në datën 18.5.2016.

Me vendimin e drejtuesit të Prokurorisë Mat, z. A.M, në datën 11.3.2016, është kryer zëvendësimi i subjektit me prokuroren A.B.

Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të jepte shpjegime pasi: (i) dukej se nuk ishte menaxhuar respektimi i afatit të njoftimit për personit nën hetim M.LL, për vendimin e dhënë mbi zgjatjen e afatit hetimor, në datën 21.1.2016, deri në datën 21.4.2016, sipas parashikimit të bërë në pikën 2 të vendimit, deri në kohën e ushtrimit të detyrës nga subjekti (mars 2016), pasi rezultonte se ky shtetas kishte marrë dijeni në datën 18.5.2016, pas 4 muajsh; (ii) referuar “urdhrit për regjistrimin e procedimit penal”, datë 21.10.2015, dukej se

⁷⁸Vendim për vlerësimin e sekuestros (gëzhojat në vendin e ngjarjes dhe copave të xhamave të makinës), datë 17.10.2015; vendim për vlerësimin e kontrollit (të banesës së shtetasit D.LL), datë 17.10.2015; vendim për vlerësimin e kontrollit (të lokalit të shtetasit XH.M), datë 17.10.2015; vendim për lejimin e përgjimeve (për bisedat telefonike midis të dyshuarit dhe personit të përfshirë në konflikt), datë 18.2.2016, dërguar gjykatës në datën 19.2.2016; urdhër, datë 29.10.2015, për kryerje veprimesh hetimore (deri në datën 20.11.2015); urdhër, datë 9.12.2015, për kryerje veprimesh hetimore (deri më 20.12.2015). Në këtë urdhër, subjekti ka cituar se është bërë zëvendësimi i OPGJ-së që ka zhvilluar veprimet hetimore (për arsye shëndetësore) dhe nga studimi i akteve ka evidentuar veprimet hetimore që nuk janë kryer duke kërkuar kryerjen sa më shpejt të tyre; urdhër, datë 22.1.2016, për kryerje veprimesh hetimore (deri më 20.2.2016).

⁷⁹Subjekti citon se disa nga veprimet hetimore të parashikuara në urdhrin e datës 9.12.2015, nuk janë kryer nga policia gjyqësore. Por, në datën 21.1.2016, policia gjyqësore ka kërkuar të kryejë disa veprime të tjera hetimore (citon veprimet konkrete), për të cilat subjekti pretendon që në fakt ato ishin parashikuar më parë në urdhër të datës 9.12.2015.

nuk ishte regjistruar edhe vepra penale “kanosje”⁸⁰ (referuar materialit nga policia⁸¹), sipas nenit 84 të Kodit Penal.

- Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar se vendimi i prokurorit për zgjatjen e afateve i njoftohet shtetasit me shkresë ose duke i deleguar oficerit të policisë gjyqësore të njoftojë palët me vendimin përkatës. Nga praktika e ndjekur, ky vendim i njoftohet palëve nga OPGJ-ja i ngarkuar me hetimet, i cili ia komunikon dhe merr nënshkrimin. Subjekti ka sqaruar se në datën 15-16 mars 2016, është larguar nga prokuroria dhe çështja është kaluar te një tjetër prokuror, ndaj kjo vonesë nuk ka ardhur si pasojë e veprimeve të tij të drejtpërdrejta. Për më tepër, afati i kundërshtimit të vendimit të prokurorit lidhet me momentin nga marrja dijëni e personit nën hetim apo të pandehurit, çka nuk passjell asnjë cenim të të drejtave të tij për të kundërshtuar këtë akt procedural apo aktet e prodhuara gjatë kësaj periudhe.

Subjekti ka sqaruar se në shumë raste nuk mund të procedohet menjëherë me njoftimin e aktit sapo vendoset zgjatja e afateve, për shkak të pamundësisë reale që mund të ketë OPGJ-ja për t’ia njoftuar, për shkak të ngarkesës në punë, për shkak të mosgjetyes së personit etj.

Subjekti është shprehur mbi ligjin procedural, i cili ka parashikuar qartë se kur palët njihen me vendimin për zgjatjen e afatit të hetimit, brenda 10 ditëve kanë të drejtën e ankimit, si dhe mund të kërkojë pavlefshmëri apo papërdorshmëri të akteve të krijuara në vijim, duke qartësuar se ai nuk di që këto kërtime të kenë ndodhur, duke mos cenuar as hetimin, as provat dhe as të drejtat e të pandehurit apo personit nën hetim.

Në lidhje me mungesën e shënimeve në regjistër dhe urdhrin për regjistrimin e procedimit penal datë 21.10.2015, ku nuk është regjistruar edhe vepra penale e “kanosjes”, sipas nenit 84 të Kodit Penal, subjekti ka sqaruar se, pavarësisht këtij fakti, hetimi ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm, duke mos u kufizuar në modalitetet e shënimeve në regjistër. Ai ka theksuar se vepra penale e “kanosjes” përbën kundërvajtje penale dhe mungesa e shënimeve nuk kushtëzonte kryerjen e veprimeve të tilla procedurale si lejim përgjimi, etj.

Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe rrethanave të rezultuara lidhur me mosadministrimin e njoftimit në kohë të vendimit të ndërmjetëm për zgjatjen e afatit të kryerjes së hetimeve, për sa kohë megjithë marrjen dijëni vendimi nuk është ankimuar nga personi nën hetim, vlerëson se ky mosadministrim nuk mund të ngrihet në nivelin e cënimit të kritereve matës të rivlerësimit profesional. Sa i përket mosregjistrimit të veprës penale të kanosjes, sipas nenit 84 të Kodit Penal, trupi gjykues vlerëson shpjegimet e subjektit kur konkretizohet se janë kryer hetime pa u kufizuar në modalitetet e shënimeve në regjistër. Në verifikim të akteve të administruara rezultoi se në informacionin e sallës operative të Komisarariatit të Policisë Mat njoftohet edhe kanosja e bërë nga shtetasi LL, duke qëlluar me armë. Në referimin e veprës penale të po këtij komisaritati nga OPGJ-ja, nuk referohet vepra penale e kanosjes. Ndërsa rezultoi se nga veprimet hetimore të subjektit të rivlerësimit është urdhëruar kryerja e përgjimeve, rezultatet e të cilave (bisedat e zhvilluara) janë konsideruar në kërkimin e organit të akuzës për të kërkuar gjykimin e procedimit penal edhe për veprën penale të kanosjes. Në këtë këndvështrim, trupi gjykues nuk konstaton problematika të karakterit procedural, lidhur me hetimet e kryera për këtë çështje, për sa kohë veprimet e nisura nga subjekti dhe të pasuara nga zëvendësuesi kanë qenë në sinkron dhe kanë bërë të mundur ngritjen e të gjithë akuzave në adresë të të akuzuarit. Në përfundim nuk vërehen problematika që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

⁸⁰Nga aktet e dosjes rezulton se ky veprim procedural është kryer nga prokurori zëvendësues, ku për kryerjen e kësaj vepre është kërkuar dënim nga organi i akuzës, dhe më tej është vendosur edhe dënimi përkatës nga gjykata.

⁸¹Faqe ***, volumni nr. 2.

Në lidhje me denoncimet e paraqitura në Komision, për subjektin e rivlerësimit Leonard Filopati, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar, si vijon:

Në Komision rezulton se janë paraqitur dy denoncime, nga i njëjti denoncues, me të njëjtin objekt dhe ndaj disa subjekteve, ndër të cilët, edhe subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje me dy denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar, si vijon:

1. Denoncimet⁸² e shtetasit E.P

1.1 Denoncimet e këtij shtetasi, i referohen disa subjeteve (prokuror dhe gjyqtar), duke përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Përgjithësisht pretendohet për korrupsion të kryer nga ana e tyre, gjatë ushtrimit të detyrës, në bashkëpunim me njëri tjetrin.

1.2 Denoncuesi i referohet çështjes së arrestimit në datën 25.8.2019, të vëllait të tij, shtetasit E.P, akuzuar për mbajtje droge dhe kundërshtim të policisë.

1.3 Denoncuesi pretendon se ka kontaktuar me subjekte të tjerë për të mundësuar lirimin e vëllait të tij. Gjithashtu, pretendon se i është kërkuar një sasi parash nga një tjetër subjekt rivlerësimi nën pretendimin e bashkëpunimit me subjektin e rivlerësimit dhe gjyqtarë për të mundësuar lirimin e vëllait të tij.

1.4 Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimeve, tabelën e “grafikut të gatishmërisë për muajin gusht të vitit 2019, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, një fletë, ku evidentohen disa veprime hetimore e nënshkruar nga Drejtuesi i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe një kopje të vendimit të shkurtuar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. *** akti, datë 29.8.2019, ku evidentohet si kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë (e përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit), personi nën hetim shtetasi E.P, me objekt: *“1. Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të personit në hetim E.P i dyshuar për kryerjen e veprës penale ‘Prodhim dhe shitje të narkotikëve’ dhe ‘Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik’, parashikuar nga nenet 283 dhe 236 të Kodit Penal. 2. Të caktohet ndaj tij masa e sigurimit personal ‘arrest në burg’, parashikuar nga neni 238 i Kodi të Procedurës Penale”*.

1.5 Komisioni administroi kopjen e fashikullit penal të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸³ dhe kopjen e dosjes gjyqësore të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸⁴.

1.6 Nga fashikulli penal rezulton se subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar në datën 26.8.2019 r regjistrimin e procedimit penal nr. ***, datë 26.8.2019, për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve” dhe “kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga nenet 283 dhe 236 të Kodit Penal, ndaj personit në hetim, shtetasi E.P. Regjistrimi është bërë mbi bazën e materialeve të kallëzimit të veprës penale të ardhura nga Drejtoria e Policisë Vendore Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 26.8.2019.

1.7 Nga fashikulli penal rezulton se, me shkresën nr. *** prot./L.F, datë 27.8.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (e nënshkruar me urdhër dhe delegim nga drejtuesi i seksionit, znj. M.Z), është përcjellë “kërkesa për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit për personin e dyshuar E.P”, e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet të cilës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg”, për personin nën hetim shtetasin E.P.

1.8 Me vendimin nr. *** akti, datë 29.8.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur: *“1. Vleftësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë të kryer nga policia gjyqësore, më*

⁸²Shkresat nr. *** prot., datë 31.10.2019 dhe nr. ***, datë 31.10.2019.

⁸³Shkresë nr. *** prot., datë 15.3.2022.

⁸⁴Shkresë nr. *** prot., datë 11.3.2022.

datë 25.8.2019, ora 23:30 ndaj personit nën hetim E.N.P, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'prodhim dhe shitje të narkotikëve', parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, dhe 2. Caktimin ndaj personit nën hetim E.N.P masën e sigurimit personal 'arrest në shtëpi', parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale”.

1.9 Rezulton se, me shkresën nr. *** prot./L.F, datë 30.8.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, për dijeni Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ka dërguar ankimin e prokurorit (subjektit të rivlerësimit) ndaj vendimit nr. *** akti, datë 29.8.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar ankimit, rezulton se subjekti ka arsyetuar faktet, provat, rrethanat dhe vlerësimin e tij mbi nevojën e caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg” dhe në përfundim ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. *** akti, datë 29.8.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me caktimin e masës së sigurimit personal për personin nën hetim E.P, duke caktuar si masë sigurimi personal ndaj tij “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

1.10 Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.***, datë 11.9.2019, ka vendosur: “Miratimin e vendimit gjyqësor nr.*** akti, datë 29.8.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

1.11 Duket se subjekti ka qenë konseguent në qëndrimin e tij, lidhur me masën e sigurimit ndaj personit nën hetim, duke kërkuar fillimisht në gjykatë caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” dhe, më pas, duke bërë ankim ndaj vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe kërkuar sërish caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

1.12 Në tërësi, duket se nuk vërtetohen pretendimet e denoncuesit.

2. Denoncim⁸⁵ i shtetasit N.B

Denoncuesi në ankimin e tij identifikon disa çështje, problematikat e të cilave ia atribuon subjektit të rivlerësimit.

2.1 Në tërësi të denoncimit, shtetasi nuk prezanton shkelje të subjektit të rivlerësimit në ndonjë çështje që të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

2.2 Fillimisht, denoncuesi konteston emërimin e subjektit nga OPGJ-ja në prokuror, duke pretenduar se emërimi është kryer në shkelje të procedurave ligjore të asaj kohe. Njëkohësisht, konteston edhe kalimin e subjektit nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kushtet kur ishte nën efektet e masës disiplinore.

2.3 Në vijim, parashtron se subjekti ka ndikuar në çështjen hetimore që i përket ngjarjes së rëndë të rrëmbimit të shtetasit J.P, duke dëmtuar hetimin në favor të autorëve, pasi çështja ka qenë kompetencë e SPAK-ut. Për këtë çështje pretendon se ka qenë subjekti i rivlerësimit, i cili i ka dhënë gazetares pamjet filmike të trupit të viktimës, të cilat i administronte nga kamerat e sigurisë, me qëllim publikimin e tyre në emision pa u përfunduar hetimet e çështjes.

2.4 Denoncuesi jep të dhëna, gjithashtu, edhe në lidhje me atentatin e munguar ndaj shtetasit A.DH, për të cilin pretendon për shkelje dhe favorizim të autorëve.

2.5 Denoncuesi ka pretenduar për nisjen e hetimit nga subjekti i rivlerësimit, në kushtet e konfliktit të interesit, sa i përket çështjes penale në ngarkim të shtetasit P.GJ, në një kohë që subjekti ka qenë në njohje si me autorët e atentatit, ashtu edhe me shtetasin GJ. Ai ka sqaruar se ka dhënë dorëheqjen me pretendimin e konfliktit të interesit, pasi ka devijuar hetimin.

⁸⁵Nr. *** prot., datë 30.5.2022.

2.6 Denoncuesi pretendon edhe për marrëdhënie të subjektit të rivlerësimit me shtetasit me iniciale O. Sh., anëtar i “***”, A. B. i dënuar nga Gjykata e Romës “për trafik prostitucioni”, N. A. i dënuar nga Gjykata e Tiranës “për vrasje” dhe E. H. i dënuar në disa vende të Evropës.

a) Në lidhje me emërimet e subjektit të rivlerësimit në raport me kërkesat ligjore, si dhe në raport me masën disiplinore dhënë ndaj tij në datën 29.7.2015

Nga provat e administruara së bashku me raportin profesional të dërguar nga KLP-ja për subjektin e rivlerësimit, rezulton se:

- Me urdhrin nr. ***, datë 29.7.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm⁸⁶, subjekti i rivlerësimit është emëruar OPGJ, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier.
- Me urdhrin nr. ***, datë 31.5.2006, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit është transferuar OPGJ, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. ***, datë 4.6.2012, subjekti i rivlerësimit nga OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë është emëruar prokuror në këtë prokurori.
- Me urdhrin nr. ***, datë 29.7.2015, Prokurori i Përgjithshëm ka urdhëruar dhënien e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, bazuar në shkeljet e konstatuara nga inspektimi i këshillit të prokurorisë, mbi bazë të informacionit të dhënë nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Mat, ku dhe ushtronte detyrën subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar dhënien e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”.
- Sipas ligjit (të kohës) nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 34/4/b është parashikuar shprehimisht se kjo masë fshihet nga dosja vetjake pas një viti nga data e dhënies së saj, pra, nga data 29.7.2015.
- Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar të drejtën ankimore ndaj urdhrit të drejtuesit të prokurorisë.
- Rezulton se me Dekretin e Presidentit “Për largim prokurori”, nr. ***, datë 4.3.2016 (pas rreth tetë muajve të dhënies së masës disiplinore), është dekretuar largimi i subjektit nga detyra e prokurorit pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për shkak të shërbimit të tij në strukturat juridiko-profesionale, të Ministrisë së Drejtësisë.

b) Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se subjekti i rivlerësimit është emëruar prokuror në shkelje të procedurave ligjore të asaj kohe, Komisioni ka konstatuar se:

Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e oficerit të policisë gjyqësore prej korrikut të vitit 2005 – qershor të vitit 2012, përkatësisht: në Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor, Fier, Kavajë dhe Tiranë. Më tej, subjekti është dekretuar prokuror në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Edhe subjekti në shpjegimet e tij⁸⁷, ndër të tjera, mbi kushtet dhe kriteret e emërimit të tij nga OPGJ në prokuror rrethi, ka cilësuar edhe një herë të njëjtin legjislacion të kohës, kur dhe ka ndodhur veprimi, sikurse lartpërmendet nga hetimi i Komisionit, por duke qartësuar, gjithashtu, se: *“Në periudhën e emërimit si prokuror, unë kisha përfunduar arsimin e lartë juridik dhe masterin shkencor në jurisprudencë; si dhe kisha mbi 6 vite e 10 muaj punë si Oficer i policisë gjyqësore pranë prokurorisë, i emëruar në datën 1.8.2005, deri në datën 4.6.2012, kur jam emëruar si prokuror. Nga sa më sipër, rezulton se ky pretendim i kallëzuesit bie pasi nga ana ime plotësoheshin të gjitha kriteret ligjore për emërimin tim si prokuror nga Presidenti i Republikës”*.

⁸⁶Referuar shkresës nr. *** prot., datë 29.7.2005.

⁸⁷ Dërguar me postë elektronike në datën 1.6.2022.

- Në të tilla kushte, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit është emëruar në detyrë në përmbushje të kriterëve të nenit 17⁸⁸ (me përjashtim të kriterit të përfundimit të shkollës së magjistraturës), duke përfshirë njërin prej kushteve të veçanta që barazohet me këtë të fundit, dhe, më konkretisht, me parashikimin e po këtij neni, për shkak se më parë kishte përmbushur kohën e ushtrimit të detyrës si OPGJ.

c) Në lidhje me emërimin e subjektit të rivlerësimit prokuror në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilën denoncuesi pretendon se është emëruar në kundërshtim me ligjin, pasi subjekti kishte një masë disiplinore.

- Subjekti është pyetur për këtë çështje dhe në shpjegimet e tij ka deklaruar se: “Në lidhje me emërimin tim si prokuror në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, sqaroj se në lidhje me masën disiplinore që pretendohet nga ankuesi anonim se përbënte pengesë për kalimin tim në Tiranë, masa disiplinore ndaj meje është dhënë në datën 29.7.2015 dhe për shkak se ajo masë ishte krejtësisht e padrejtë⁸⁹ dhe në kundërshtim me ligjin e kohës, të cilën unë e kam ankimuar në gjykatë dhe aktualisht, edhe pse kanë kaluar rreth 7 vjet, është në pritje të shqyrtimit nga Gjykata e Lartë. Theksoj se kjo masë disiplinore ‘vërejtje me paralajmërim’, është dhënë padrejtësisht nga ish-Prokurori i Përgjithshëm A.LL (tashmë i dënuar). Referuar ligjit, në fuqi të kohës për organizimin e prokurorisë, nr. 8737, datë 12.2.2001, ‘Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë’ (i ndryshuar), nenit 33 të tij, që parashikon se: ‘1. Për shkelje të disiplinës ndaj prokurorëve merren këto masa: a) ...; (b) vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra; ...2. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat ... ‘b’ dhe ... të pikës 1 të këtij neni jepen me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm dhe shënohen në dosjen vetjake të prokurorit...4. Masat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni fshihen nga dosja kur kanë kaluar: b) një vit nga data që është dhënë masa sipas shkronjës ‘b’.

- Nga sa më sipër, me kalimin e periudhës prej 1 viti, pra në datën 29.07.2016, sektori i burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme duhej ta kishte fshirë masën disiplinore nga dosja ime personale. Emërimi im në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është bërë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në vitin 2019, disa vite pas parashkrimit të masës disiplinore. Gjatë kësaj periudhe komandimi, vlerësimi i kryer nga institucioni - Ministria e Drejtësisë ka qenë në nivelin shumë mire gjatë gjithë periudhës që kam punuar atje”. Subjekti ka depozituar rekursin e datës 29.12.2015.

- Në verifikim të të dhënave të administruara në raport me ligjin e zbatueshëm, konkretisht, referuar shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 33, të ligjit nr. 8737/2002, rezulton se masa disiplinore e dhënë ndaj subjektit në vitin 2015 shuhej në vitin 2016, pas një viti nga dhënia e saj dhe që për pasojë emërimi i subjektit si prokuror në vitin 2019, duket se nuk është kryer në shkelje të ligjit, pavarësisht mos fshirjes së saj nga dosja vetjake e subjektit të rivlerësimit, pasi

⁸⁸Ligji nr. 8737, datë 12.2.2001, ka parashikuar shprehimisht në nenin 17 të tij “KREU VI EMËRIMI I PROKURORIT/Neni 17/Kushte të përgjithshme (shtuar germa “ë” me ligjin nr. 10051, datë 29.12.2008)/Emërohet prokuror në njërin nga prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, personi që plotëson këto kushte: (a) është shtetas shqiptar; (b) ka zotësi të plotë për të vepruar; (c) ka arsim të lartë juridik; (ç) ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës; (d) nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale; (dh) nuk është larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike brenda një afati prej tre vjetësh nga data e depozitimit të kërkesës; kur shkelja disiplinore është kryer gjatë ushtrimit të funksionit si gjyqtar, prokuror, oficer i policisë, noter ose avokat, afati është pesë vjet; (e) është jo më pak se 25 vjeç; (ë) ka cilësi të larta morale dhe profesionale. Neni 18/Kushte të veçanta (ndryshuar me ligjin nr. 10051, datë 29.12.2008). Mund të emërohet prokuror edhe personi që nuk ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, nëse përmbush kriteret e tjera të përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji dhe njërin prej kushteve të mëposhtme: (a) ka punuar gjyqtar ose prokuror; (b) ka punuar jo më pak se 5 vjet oficer i policisë gjyqësore. Me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, Presidenti i Republikës mund të emërojë në prokuroritë e shkallës së parë, deri në 10 për qind të numrit të përgjithshëm të prokurorëve, shtetas, të cilët kanë punuar më parë prokurorë, gjyqtarë apo oficerë të policisë gjyqësore, që përmbushin kriteret e germave “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë” të nenit 17 dhe të germës “b” të këtij neni.

⁸⁹Subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara me e-mail në datën 13.6.2022, lidhur me masën disiplinore, ankimin e bërë ndaj saj në gjyqësor, si dhe duke e ndërthurur shpjegimin me hetimin e çështjes K trajtuar në këto rezultate.

duket se ekzekutimi varet dhe është përgjegjësi e strukturës përkatëse, e cila nuk ka lidhje dhe as mund të penalizojë subjektin në karrierën e tij.

ç) Komisioni administroi informacionin e dërguar nga SPAK-u⁹⁰, lidhur me statusin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit/ve (për viktimën J.P) (gjithnjë sipas të dhënave të denoncimit), nga ku mësohet se SPAK-u ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në datën 14.2.2020, me nr. **, për veprat penale të parashikuara nga nenet 109, 283/a, 303, 278/1, etj., në ngarkim të shtetasit B.H. Në vijim, SPAK ka konfirmuar ndarje të këtij procedimi penal edhe në dy procedime të tjera, ku pas përfundimit për dy prej tyre është vendosur dërgimi i tyre në gjyq dhe se çështjet janë në fazën e gjykimit, ndërsa njëri procedim vijon të jetë në fazën e hetimit penal.

- Edhe subjekti është pyetur për këtë çështje dhe në shpjegimet e tij ka deklaruar se: *“Lidhur me pretendimin e hetimeve për rrëmbimin e shtetasit J.P, kjo çështje më është caktuar mua në bazë të grafikut të gatishmërisë të seksionit përkatës. Për shkak të rëndësisë së faktit dhe situatës së ngutshme, kjo është një nga çështjet në të cilën ka pasur një impenjim maksimal nga ana ime si prokuror dhe nga policia gjyqësore, duke zhvilluar një hetim të shpejtë, të plotë, të gjithanshëm dhe profesional, e cila u finalizua me zbulimin e autorëve dhe arrestimin e 14 personave, ku një pjesë tyre u morën në përgjegjësi penale për vepra të rënda penale. Për shkak të parashikimeve procedurale të neneve 75/a dhe 84 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat përcaktojnë kompetencën lëndore të hetimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Prokurorisë pranë kësaj gjykate (SPAK), ku përfshihet çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale. Për këtë procedim penal është vendosur shpallja e moskompetencës dhe kalimi i akteve SPAK-ut. Theksoj se vendimi për shpalljen moskompetencës lëndore për këtë çështje penale (procedimi penal nr. ***) është bërë në datën 7.2.2019. Ritheksoj se nga ana ime në çdo rast janë zbatuar me përpikëri dispozitat procedurale për ruajtjen e sekretit profesional dhe në asnjë rast hetimor, unë nuk kam paraqitur të dhëna hetimore tek gazetaret apo gazetarja K.L, sikurse pretendohet, për sa kohë që unë kam pasur dosjen në hetim dhe është administruar prej meje. Për të treguar se ky pretendim nuk qëndron, ju bëj me dije, se me sa kam dijeni, i ndjeri J.P ishte me origjinë nga rrethi i Pukës dhe jo i Mirditës. Gjithsesi theksoj se me viktimën/ familjarët e tij, apo edhe personat nën hetim, unë nuk kam pasur asnjë rrethanë përjashtimore, të tillë që të mund të përbënte shkak për përjashtimin tim nga hetimi në bazë të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale”.*

- Gjithashtu, subjekti ka depozituar grafikun e gatishmërisë për muajin janar të vitit 2020 nga ku rezulton se subjekti ka qenë prokuror i gatshëm në datat 15, 16 dhe 17 janar 2020.

ç) Komisioni administroi⁹¹ fashikullin penal që i përket të akuzuarit/ve lidhur me atentatin e munguar ndaj shtetasit A.DH (sipas të dhënave të denoncuesit).

i. Në lidhje me këtë çështje, sipas akteve të dosjes rezulton se shtetasi A.DH ka kallëzuar në Komisaratin e Policisë Nr. ***, në tetor të vitit 2020, rrethanat e çështjes të cilat i janë bërë prezent nga administratori i pallatit ku ka banesën e tij. Shtetasi A.DH ka mësuar prej administratorit se teksa i afrohej ashensorit për të shkuar në apartamentin e tij me gjithë vajzën, paska pasur dy shtetas të paidentifikuar të maskuar me armë në dorë të cilët e ndiqnin, por nuk kanë arritur në futeshin në ashensor. Në këto rrethana, shtetasi A.DH ka kallëzuar situatën, duke bërë me dije se dyshimet e tij hidheshin te dy kontrata të falsifikuara nga një noterë, ku pretendonte se përmes falsifikimit i ish-in marrë firma palës blerëse, e cila nuk rezultonte në atë kohë të kishte qenë në Shqipëri. Për këto dyshime në dosje është administruar edhe kallëzimi i këtij shtetasi për noteren dhe palën blerëse. Ndërkohë ka sqaruar se blerësja e pronës ishte vajza

⁹⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2022.

⁹¹Me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2022, të Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

e një personazhi të njohur në vend dhe shtetasi A.DH hidhte dyshime të forta se prej këtij personazhi po kërcënohej. Në të tilla kushte është regjistruar procedimi penal me nr. ***, datë 16.10.2020, si dhe ka vijuar kryerja e disa veprimeve hetimore për zbardhjen e çështjes, duke u marrë e sekuestruar kamerat e pallatit, është kryer identifikimi i shtetasve, më tej, janë bërë kontrollet e banesës ku dhe janë gjetur e sekuestruar armë dhe mjete të tjera, janë pyetur persona të dyshuar të kallëzuar nga kallëzuesi DH. Nga subjekti i rivlerësimit janë kërkuar vleftësimet e ndalimit dhe caktimet e masave të sigurimit personal “arrest me burg” për disa shtetas, ndër to edhe për shtetasin G.L si i dyshuari kryesor, pasi gjatë hetimeve ka pranuar se banesa ku janë gjetur armët është e gjyshërve të tij dhe se personat e tjerë nuk kanë asnjë lidhje me to. Të dyshuarit e tjerë kanë deklaruar se nuk kanë dijeni për ngjarjen.

Në vijim, pas hetimeve të kryera, administrimit të akteve të ekspertimit, komunikimit të tyre në What App, etj., subjekti i rivlerësimit i ka njoftuar shtetasit G.L marrjen si të pandehur.

Subjekti, pas dërgimit të kërkesës për gjykim dhe pranimit të saj nga gjykata, në konkluzionet përfundimtare ka kërkuar dënimin e këtij shtetasi (më 16.6.2021) me 3 vjet e 6 muaj dhe në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me 2 vjet e 4 muaj, për veprat penale “mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe municioneve”, “prodhimi, mbajtja blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, parashikuar nga nenet 278/3 dhe 279/2 të Kodit Penal. Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 16.6.2021, ka vendosur dënimin e tij me 1 vit e dy muaj burgim.

ii. Për këtë çështje, subjekti është pyetur dhe në shpjegimet e tij ka deklaruar se: *“Lidhur me pretendimin e hetimeve për kallëzimin e bërë nga ana e shtetasit A.DH, nga ana ime është hetuar kjo çështje pasi ditën e ngjarjes unë kam qenë i gatshëm dhe, për rrjedhojë, kjo çështje kishte të nevojshme kryerjen e disa veprimeve të ngutshme hetimore si përgjimi, vëzhgimi, kontrollet etj. Pas kryerjes së të gjitha hetimeve është vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale me Nr. ***, viti 2020, me të pandehur G.L, i akuzuar për veprat penale ‘mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municioneve’, ‘prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta’, të parashikuar nga nenet 278/3 dhe 279/1 të Kodit Penal, i cili, më pas, është dënuar nga gjykata”.*

iii. Subjekti ka depozituar grafikun e gatishmërisë për muajin tetor të vitit 2020, nga ku rezulton se subjekti ka qenë prokuror i gatshëm në datat 14, 15 dhe 16 tetor 2020, ku dhe përfshihet kallëzimi i bërë nga shtetasi A.DH, si dhe vendimin gjyqësor të lartpërmendur të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

d) Në lidhje me çështjen që i përket të akuzuarit/ve (për viktimën P.GJ, sipas të dhënave të denoncuesit)

i. Për këtë çështje është pyetur subjekti dhe në shpjegimet e tij ka deklaruar se: *“Lidhur me pretendimin e hetimeve për atentatin e bërë shtetasit P.GJ, nga ana ime është hetuar fillimisht kjo çështje, pasi ditën e ngjarjes unë kam qenë i gatshëm dhe, për rrjedhojë, kjo çështje kishte të nevojshme kryerjen e disa veprimeve të ngutshme hetimore si përgjimi, vëzhgimi, kontrollet etj. Që në momentin e parë që ka ndodhur ngjarja, unë kam shkuar në vendin e ngjarjes për kryerjen e veprimeve të para hetimore. Pavarësisht se nuk ndodhesha në kushtet e konfliktit të interesit të parashikuara nga neni 17 i Kodit të Procedurës Penale, duke pasur parasysh origjinën e subjekteve procedurale, për të shmangur çdo lloj paragjykimi apo dyshimi për objektivitetin tim nga palët, nga ana ime është paraqitur kërkesa për përjashtim, e cila është pranuar nga drejtuesi i institucionit dhe dosja i ka kaluar një tjetër prokurori-regjistruar si procedimin penal nr. ***, datë 15.9.2020, për veprën penale ‘vrasje për gjakmarrje e mbetur ne tentative’ dhe ‘shkatërrimi i pronës me eksploziv’, parashikuar nga nenet 78/a, 22 dhe 152, të Kodit Penal. Ritheksoj se në bazë të neneve 15, 16, 17 dhe 18 të Kodit të Procedurës Penale, ngjarja e mësipërme ka ndodhur ne datën kur unë isha i gatshëm dhe kisha detyrim ligjor të*

merrja pjesë në veprimet e para dhe të ngutshme hetimore, të cilat nuk mund të përsëriteshin në një moment të dytë dhe mungesa e të cilave do të dëmtonte zbardhje e ngjarjes.

ii. Gjithashtu, për këtë çështje, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka informuar⁹² se procedimi penal nr. ***, për veprën penale “shkatërrim prone me eksploziv”, parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal, pa autor, me viktimë shtetasin A.GJ, për të cilin prokurori Leonard Filopati ka hequr dorë në datën 14.10.2020 është deri aktualisht në hetim nga një tjetër prokuror.

iii. Subjekti ka depozituar grafikun e gatishmërisë për muajin shtator 2020, nga ku rezulton se subjekti ka qenë prokuror i gatshëm në datat 15 dhe 16 shtator 2020, ku përfshihet kallëzimi i bërë, si dhe kërkesa për dorëheqje⁹³ nga hetimi i procedimit.

✓ Për sa më sipër, bazuar në nenin “E”/2, trupi gjykues vlerëson se për sa kohë kjo çështje rezulton të jetë nën shqyrtim, nuk ka kompetencë për të shtrirë rivlerësimin e aftësisë profesionale ndaj subjektit të rivlerësimit.

dh) Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për marrëdhënie të subjektit të rivlerësimit me shtetasit me iniciale O. Sh. anëtar i “***”, A. B. i dënuar nga gjykata e Romës për trafik prostitucioni, N. A. i dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranës për vrasje dhe E. H. i dënuar në disa vende të Evropës, Komisioni administroi informacionin e prokurorive të rretheve gjyqësore, ku subjekti ka ushtruar detyrën e OPGJ-së dhe të prokurorit, nëse përgjatë saj ka hetuar, mosfilluar, pushuar, etj. çështje në ngarkim apo në cilësinë e kallëzuesve me shtetasit O.SH, A.B, N.A dhe E.H.

i. Nga informacioni i dhënë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe Kavajë⁹⁴ nuk ka konfirmuar çështje të hetuara mosfilluara apo pushuara në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur apo çështje të kallëzuara prej tyre.

ii. Edhe subjekti është pyetur për këtë pretendim të denoncuesit dhe në shpjegimet e tij ka deklaruar se: *“Lidhur me personat e cituar nga ankuesi dhe konkretisht: O.SH, N.A, A.B dhe E.H, nuk i kam hetuar, mosfilluar apo dërguar në gjykim çështje, ku këta shtetas kanë qenë të kallëzuar apo kallëzues, viktima apo të pandehur dhe, aq më tepër, të jem përdorur nga këto shtetas për veprime të paligjshme në interesin e tyre. Sqaroj emrin e shtetasit O.SH e kam lexuar vetëm në media, si edhe shtetasin A.B e njoh si një nga noterët që ka zyrat përballë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sa më sipër, theksoj se të gjithë pretendimet e ankuesit anonim nuk qëndrojnë, por janë thjeshtë që të hedhin baltë lidhur me emrin tim, duke dyshuar se personi që i kanë shkruar mund të jetë person që është hetuar apo është kërkuar dënimi i tij nga ana ime si prokuror”.*

iii. Komisioni, gjithashtu, ka aksesuar edhe informacionet mediatike për të mësuar lidhur me faktin nëse në ngarkim të tyre referohen çështje penale, të cilat gjejnë zbatim hetimi nga parashikimet e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të hetimit të kriterit të figurës, por gjithnjë nëse do të identifikonin marrëdhënien e subjektit me këta persona. Në këtë drejtim, nuk vërehen të dhëna për shtetasin O.SH dhe A.B, ndërsa identifikohen të dhëna për shtetasin N.A, por në shtetin e Kosovës në qytetin e ***, ku sipas medias⁹⁵ ky shtetas akuzohet për grabitje e posedim të paautorizuar të narkotikëve. Po ashtu, edhe nga aksesi i kryer për shtetasin E.H rezulton se ky shtetas së bashku me të tjerë janë shpallur në kërkim nga policia, pasi akuzohen për falsifikim të dokumenteve dhe trafikim të automjeteve⁹⁶.

⁹²Me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2022.

⁹³Depozituar me e-mail në datën 6.6.2022.

⁹⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2022.

⁹⁵https://betimiperdrejtesi.***

⁹⁶https://www.***news.tv/****

- Por, Komisioni, lidhur me këtë çështje, mbajti në vëmendje çmuarjen e informacionit në mënyrë të rezervuar, pasi nga aksesi në dokumentacionin e gjendjes civile në territor vendi rezultuan dy shtetas me të dhënat N.A, mbi 20 shtetas me të dhënat E.H, dy shtetas me të dhënat A.B dhe një shtetas me të dhënat O.SH. Në të tilla kushte, për sa kohë nuk u identifikuan çështje të hetuara për këta shtetas nga subjekti i rivlerësimit, por edhe për sa kohë të dhënat e grumbulluara nga aksesi merren të rezervuara dhe në asnjë rast nuk hodhën dritë për ndonjë marrëdhënie të mundshme të këtyre shtetasve me subjektin e rivlerësimit, duket se edhe në këtë rast nuk provohen pretendimet e denoncuesit.

e) Nga aksesi në sistemin *TIMS* dhe AMF, nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga Ministria e Drejtësisë lidhur me veprime noteriale, Komisionit nuk i rezultoi asnjë marrëdhënie me shtetasit e lartpërmendur në asnjë formë apo mënyrë.

- Trupi gjykues, pas analizimit të të gjithë çështjeve penale trajtuar nën titullin “gjetje të tjera”, si dhe denoncimeve, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por edhe pas një hetimi të thelluar e të gjithanshëm, ka vlerësuar se në tërësi ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të ndikojnë në rivlerësimin e kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të gërmës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “i aftë”.

Vlerësimi tërësor i çështjes

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, çmon se:

a) Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

b) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

c) Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të gërmës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Leonard Filopati, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 6.7.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka